



YOUTH

VOICES ||| CHOICES

Qasja e të rinjve në informacion, edukim dhe kujdes ndaj shëndetit seksual dhe riprodhues në Kosovë gjatë kohës së Covid

Raport Hulamtues

Zërat e të Rinjëve, Zgjedhjet e të Rinjëve është një projekt trevjeçar i dedikuar për të siguruar që kujdesi shëndetësor seksual dhe riprodhues në Ballkanin Perëndimor të bëhet më i qasshëm dhe më miqësor ndaj të rinjve në kohë më afatgjate, duke mësuar nga përvoja e Covid-19. Kjo punë fokusohet veçanërisht në përvojat dhe nevojat e të rinjve nga grupet që përballen me barriera sistematike për aksesin në kujdes. Të rinjtë janë në qendër të projektit, duke punuar në partneritete me shumë palë si studiues, avokues dhe aktivistë.

Partnerët e projektit Zërat e të Rinjëve, Zgjedhjet e të Rinjëve

Koordinimi: IPPF Rrjeti Evropian

Implementimi:

Qendra Shqiptare për Popullsi dhe Zhvillim
Instituti për Popullsi dhe Zhvillim
(Bosnjë dhe Hercegovinë)
Shoqata Bullgare e Planifikimit Familjar dhe
Shëndetit Seksual
Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe
Hulumtime (Kosovë)
Shoqata e Edukimit dhe Hulumtimit Shëndetësor
(Maqedonia e Veriut)



Metodologjia e hulumtimit, udhëzimet dhe shkrimi i këtij raporti u kryen nga Noverna Analytics and Research. Ekipet lokale në pesë vendet implementuese u përqendruan të trajnojnë të rinjtë për të kryer hulumtimin.

Partnerët e projektit dëshirojnë të falënderojnë të gjithë të rinjtë, partnerët dhe palët e tjera të interesuara që kanë kontribuar në këtë hulumtim dhe publikimin e gjetjeve të tij.



Projekti Zërat e të Rinjëve, Zgjedhjet e të Rinjëve financohet nga Merck përmes programit të saj Merck for Mothers.

Parathënie

Covid-19 krijoi krizën më të madhe shëndetësore dhe socio-ekonomike të gjeneratës tonë. Shumë sisteme shëndetësore u sfiduan nga masat kufizuese të nxituara për t'iu përgjigjur pandemisë, duke rezultuar në heqjen e prioriteteve të disa shërbimeve ekzistuese të kujdesit shëndetësor. Pothuajse në të gjitha vendet evropiane, Covid-19 pati një ndikim negativ në ofrimin e rëndësishëm të kujdesit seksual dhe riprodhues, përfshirë shëndetin e nënës dhe planifikimin familjar, për gratë dhe grupet e cënueshme, përfshirë të rinjtë. Pandemia zbuloi gjithashtu dobësi brenda sistemeve tona dhe ekspozoi faktin se vendet nuk janë të përgaditura në mënyrë adekuate për t'u marrë me emergjencat shëndetësore.

Për të ndihmuar në sjelljen e ndryshimeve pozitive për të rinjtë, Rrjeti Evropian IPPF po punon për forcimin e sistemeve të kujdesit shëndetësor përmes projektit Zërat e të Rinjëve, Zgjedhjet e të Rinjëve dhe për të hequr të gjitha llojet e barrierave që i pengojnë të rinjtë të kenë qasje në kujdesin thelbësor shëndetësor në pesë vende të Ballkanit: Shqipëri; Bosnjë dhe Hercegovinë; Bullgaria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Ne jemi duke u fokusuar veçanërisht në nevojat e atyre që jetojnë në zona të largëta, si dhe të atyre nga komunitetet që përballen me kushte sfiduese sociale, si romët.

Si bazë për këtë punë, ne prodhuam një studim për të na dhënë një pamje të qartë të ndikimit të pandemisë në ShSR të të rinjve. Ky raport paraqet gjetjet e atij studimi, të kryer nga dhe mes të rinjve në pesë vende të Ballkanit. Studimi dokumenton nevojat dhe përvojat e të rinjve për ShSR dhe perspektivat e ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe palëve të tjera të interesuara për këto nevoja.

Ai gjithashtu kap nevojat e këtyre të fundit teksa ofrojnë shërbime, informacione dhe edukim për të rinjtë, duke u mbështetur në përvojën e tyre me Covid-19.

Të rinjtë janë në qendër të këtij projekti: ata ishin pjesë e ekipeve kërkimore dhe si hap tjetër, do t'i bashkohen grupeve të ekspertëve të cilët do të bazohen në këtë raport për të zhvilluar rekomandime për ndryshimin e politikave në nivel kombëtar dhe rajonal.

Ftojme lexuesit e këtij raporti t'i bashkohen këtyre grupeve të ekspertëve dhe të mbështesin luftën tonë për sisteme të qëndrueshme shëndetësore dhe edukuese në Ballkan që integrojnë shërbimet dhe edukimin e ShSR dhe mos i lënë të rinjtë pas, gjatë dhe pas krizës. Gjetjet e paraqitura këtu tregojnë qartë se planifikimi familjar, shëndeti i nënës dhe kujdesi ndaj DhSMGj janë thelbësore për mirëqenien mendore dhe fizike të një të riu.

Përfundimi i këtij raporti, në shkurt dhe mars 2022, ka përkuar me një krizë tjetër që godet Evropën: urgjenca humanitare që shpaloset në Ukrainë, duke shtyrë miliona refugjatë të kërkojnë siguri dhe mbrojtje në vendet përreth. Ndërsa Evropa po përballlet me reagimin e saj ndaj situatës, gjetjet në këtë raport konfirmojnë besimin tonë se ofrimi i edukimit seksual cilësor dhe të qasshëm, informacionit dhe kujdesit miqësor-shëndetësor ndaj të rinjve për ShSR duhet të sigurohet për të gjithë të rinjtë në baza të vazhdueshme – para, gjatë dhe pas një krize.

PËRMBAJTJA

Hyrje dhe informata të përgjithshme	3
Hulumtimi dhe Objektivat	5
Dizajni dhe qasja hulumtuese	6
Metodologjia primare e hulumtimit dhe parametrat e mostrimit	7
Qasja analitike dhe kufizimet e hulumtimit	8
Gjetjet kryesore	12
Kërkimi i informatave dhe qasja në informata mbi shëndetin seksual dhe riprodhues	13
Qasja në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues	32
Ndikimet emocionale dhe personale të pandemisë Covid-19	47
Shëndeti mendor	51
Dhuna seksuale dhe dhuna me bazë gjinore	56
Vlerësim i reagimit institucional ndaj Covid-19	61
Praktikat pozitive	63
Praktika që rekomandohen për të ardhmen	69
Aspektet kryesore që duhet marrë parasysh	71

A. Hyrje dhe informata të përgjithshme

Stigma dhe diskriminimi, faktorët socio-ekonomikë dhe distanca gjeografike janë barrierë që ua vështirësojnë grupeve të cenueshme të shoqërisë qasjen në shërbimet shëndetësore dhe kërkimin e ndihmës. Në gjithë botën ka indikacione të qarta se pandemia Covid-19 ka ndikuar në qasjen në informata për një gamë të gjerë temash që lidhen me shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese (ShDSR), dhe ofrimin e shërbimeve të shëndetit seksual dhe riprodhues (ShSR). Pandemia gjithashtu ka vënë në pah brishtësinë e sistemeve dhe mungesën e gatishmërisë së shteteve për t'u përballur me emergjencat shëndetësore.

Pozita e të rinjve në këtë mjedis të ri paraqet sfida specifike. Në veçanti, ndikimi tek të rinjtë që ka qarkullimi i numrit të madh të dezinformatave për çështjet që lidhen me ShSR-në, barrierat për qasje në edukim seksual dhe pengesat në lidhje me marrjen e informatave dhe qasje në shërbimet e ShSR-së janë nënvlerësuar ose anashkaluar të gjitha gjatë pandemisë Covid-19. Duke ditur këtë gjë, është e qartë se ekziston një nevojë thelbësore në rritje dhe njëherësh edhe një mundësi për t'i identifikuar

boshllëqet dhe mësimet e nxjerra dhe për t'i ndarë praktikën e mira në mënyrë që të forcohen sistemet shëndetësore, të vazhdohet ofrimi i edukimit seksual në mënyrën e duhur dhe gjithashtu të përgatiten plane afatshkurtra dhe afatgjata gjithpërfshirëse për të rinjtë. Prandaj, nevojitet një analizë e detajuar dhe njohuri më të mira lidhur me ndikimin që kanë krizat sikur pandemia Covid-19 në Shëndetin Seksual dhe Riprodhues të të rinjve.

Në këtë kontekst, IPPF-EN (Federata Ndërkombëtare e Prindërimit të Planifikuar – Rrjeti Evropian) e ka kryer këtë hulumtim si fazë fillestare të një projekti dyvjeçar (2021–2023) të financuar nga programi “Merck for Mothers”, i cili synon të kontribuojë në rritjen e qasjes së të rinjve në shërbime dhe informacione për ShSR gjatë dhe pas situatave emergjente në pesë vende në Ballkanin Perëndimor, përkatësisht në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kosovë dhe Maqedoni të Veriut.

Ky dokument përbën raportin e detajuar vendor për hulumtimin e kryer në Kosovë gjatë vitit 2021.

B. Hulumtimi dhe Objektivat

Qëllimi i hulumtimit ishte që të kuptohet më mirë ndikimi që ka pasur pandemia Covid-19 në qasjen e të rinjve në shërbime, edukim dhe informata për ShSR dhe të identifikojë mënyra për t'i adresuar nevojat e ShSR për të rinjtë e moshës 14-30 vjeç. Për të arritur këtë qëllim, janë bërë hulumtime dhe analiza në lidhje me:

- Nevojat e të rinjve për ShSR si rrjedhojë e pandemisë Covid-19 në lidhje me qasjen dhe përdorimin e informacioneve që kanë të bëjnë me ShDSR dhe shërbimet përkatëse të ShSR, më konkretisht, lidhur me aspektet fizike, psikologjike dhe psikosociale të jetës së tyre. Për të kuptuar plotësisht ndikimin e pandemisë Covid-19, u krahasuan nevojat e të rinjve gjatë pandemisë me situatën para pandemisë. Në këtë kontekst, u hulumtua një gamë gjithëpërfshirëse dhe e gjerë e fushave tematike, duke përfshirë:
 - shëndeti gjinekologjik (hormonet, menstruacionet, infeksionet dhe të tjera);
 - kontracepsioni;
 - përfshirja në praktika të sigurta seksuale;
 - shtatzënia, lindja dhe përkujdesja pas lindjes;
 - ndërprerja e shtatzënisë (të paplanifikuara);
 - infeksionet seksualisht të transmetueshme (IST);
 - planifikimi familjar dhe vendimi për të pasur fëmijë;
 - fertiliteti/infertiliteti;
 - vendimmarrja për marrëdhënie seksuale dhe pëlqimi;
 - ndërtimi i marrëdhënieve të shëndetshme;
 - mesazh seksual ose përvojat seksuale në internet;
 - orientimi seksual, identiteti gjinor dhe shprehja (sjelljet) gjinore;
 - terapi hormonale/trajtimi për afirmim gjinor;
 - dhuna me bazë gjinore dhe dhuna seksuale; dhe
 - produktet (produktet e higjienës menstruale, testet e shtatzënisë, testet për vetë-përdorim për HIV dhe IST, etj.);
- Kanalet dhe burimet specifike të nevojshme dhe të përdorura nga të rinjtë për qasje në informata, edukim dhe shërbime të ShSR, duke shqyrtuar se si kanë ndryshuar në krahasim me periudhën para pandemisë, çfarë pengesash kanë hasur dhe çfarë mundësish janë ofruar;
- Ndikimi i faktorëve të jashtëm që ndikojnë në qasjen në shërbimet, informatat dhe edukimin për ShSR gjatë pandemisë Covid-19, krahasuar me periudhën para pandemisë. Kjo përfshin faktorët institucionalë, socialë, kulturorë, ekonomikë dhe

legjislativë dhe një vlerësim të reagimit institucional nga autoritetet në vend;

- Pasojat e pandemisë Covid-19 për të rinjtë në nivel personal, emocional, ekonomik, demografik, komunitar dhe sistemik;
- Mekanizmat e reagimit dhe kërkimit të ndihmës, sjelljet dhe zgjidhjet që të rinjtë i kanë adoptuar për t'i adresuar nevojat e tyre për ShSR gjatë pandemisë Covid-19; dhe
- Identifikimin dhe hartimi i praktikave më premtuese dhe pozitive për përmbushjen e nevojave të të rinjve lidhur me ShSR gjatë pandemisë Covid-19. Këtu përfshihen, ndër të tjera, praktikat dhe iniciativat e ndërmarra nga shteti, si dhe autoritetet e tjera publike shëndetësore, ministritë, institutet shëndetësore, organizatat joqeveritare (OJQ), iniciativat private, organizatat ndërkombëtare, mjekët, komunitetet dhe sektori i arsimit. Fokusi kryesor ishte në identifikimin dhe hartimin e atyre praktikave që mund t'i kenë nevojat specifike të të rinjve dhe mund të zbatohen si gjatë pandemisë Covid-19 ashtu edhe në të ardhmen. Ato përfshijnë veprime dhe masa afatshkurtra, si dhe praktika që mund të transferohen, përgjithësohen ose ripërtëriten në të ardhmen nëpërmjet ndryshimeve të legjislacionit, politikave dhe praktikave.

Si përfundim, me anë të hulumtimit dhe analizimit të fushave të lartpërmendura synohet që t'u ofrohen informacione përkatëse partnerëve të projektit dhe ekspertëve përkatës për të propozuar rekomandime specifike mbi veprimet e sugjeruara që duhen ndërmarra dhe hapat e mundshëm që duhet të ndërmerren nga politikë-bërësit dhe vendimmarrësit, dhe nga akterët kryesorë në këto fusha të shëndetësisë dhe ShSR për të përmirësuar qasjen e të rinjve në shërbimet, informacionin dhe edukimin për ShDSR gjatë dhe pas krizës së pandemisë Covid-19. Këto informata dhe rekomandime do të përdoren si bazë për zhvillimin e planeve të avokimit (në nivel kombëtar dhe gjithashtu në nivel më të gjerë rajonal në Ballkan), në kombinim me narrativat e fuqishme dhe fushatat e udhëhequra nga të rinjtë, për ta rritur ndërgjegjësimin publik, për t'i forcuar sistemet shëndetësore dhe për të përmirësuar qasjen në shërbime dhe informata për ShSR (të përshtatshme për të rinjtë) për të gjithë ata që kanë nevojë.

C.Dizajni dhe qasja hulumtuese

Për t'i arritur objektivat e përmendura më sipër, u kryen një sërë fazash hulumtuese të njëpasnjëshme të paraqitura më poshtë.

Faza 1:

Hulumtim fillestar i dokumentacionit dhe rishikim i informatave që ishin në dispozicion në domenin publik, me burim nga statistikat e publikuara zyrtare, raportet e hulumtimeve tjera, raportet e mediave dhe postimet në mediat sociale. Kjo gjë na siguroi informacione të vlefshme në lidhje me objektivat e hulumtimit dhe identifikoi më tej dimensionet dhe çështjet që do të hulumtoheshin në Fazat 2 dhe 3.

Faza 2:

Hulumtimi primar cilësor (kualitativ) i kryer në mesin e të rinjve dhe akterëve ekspertë në fushën e ShSR. Kjo fazë u realizua përmes diskutimeve në fokus grupe dhe intervistave të detajuara direkte (një me një). Gjetjet nga kjo fazë rezultuan me njohuri të vlefshme në lidhje me objektivat e hulumtimit. Këto gjetje gjithashtu ndihmuan në identifikimin e çështjeve dhe dimensioneve për matjet e mëvonshme në studimin sasior (kuantitativ) të Fazës 3.

Faza 3:

Hulumtimi primar i kryer në mesin e të rinjve për matjen sasore të fushave dhe çështjeve objektive, i realizuar me një pyetësor të strukturuar, i cili u plotësua nga vetë të rinjtë online ose nga një intervistues në intervista ballë për ballë. Kjo fazë shërbeu për marrjen e të dhënave sasore si mbështetje për gjetjet e hulumtimit tek të rinjtë.

Faza 4:

Një rishikim i detajuar i gjetjeve të hulumtimit (nga faza 1), duke rishqyrtuar të dhënat sipas gjetjeve të hulumtimit (Fazat 2 dhe 3). Kjo shërbeu për t'i vënë në plan të parë praktikat premtuese duke identifikuar ato praktika që më mirë i adresojnë nevojat e paplotësuara të të rinjve për sa i përket ShDSR.

D. Metodologjia primare e hulumtimit dhe parametrat e mostrimit

Audienca e synuar dhe përkufizimet

Hulumtimi primar (Fazat 2 dhe 3) i adresoi audiencat e mëposhtme të synuara:

- Të rinjtë e moshës 14-30 vjeç u mbuluan në Fazat 2 dhe 3, duke përfshirë burra/djem dhe gra/vajza njësoj, megjithëse gratë/vajzat përfaqësonin një përqindje më të madhe të pjesëmarrësve. Këta të rinj u rekrutuan për pjesëmarrje në bazë të cenueshmërisë së mundshme të tyre. Në nivelin fillestar, u identifikuan dy kategori të përgjithshme, përkatësisht:

- të rinjtë në situata të cenueshme, ku përfshihen ata që janë të ekspozuar ndaj kushteve të cenueshmërisë në lidhje me çështjet e ShSR për shkak të një ose më shumë prej karakteristikave të mëposhtme:

- vendndodhjes së tyre gjeografike, veçanërisht atyre që janë duke banuar në zona periferike larg qendrave kryesore urbane të ku gjendet shumica e objekteve të mëdha të kujdesit shëndetësor publik;
- përkatësisë së tyre etnike, veçanërisht personat që i përkasin grupeve etnike të pakicave ose grupeve të marginalizuara;
- personat që i përkasin komunitetit lezbike, homoseksual, biseksual dhe transeksual (LGBT), bazuar në vetëidentifikimin e tyre;
- personat që kanë qenë shtatzënë ose lindur gjatë pandemisë Covid-19; dhe
- personat me status më të ulët socio-ekonomik dhe që banojnë në zona urbane; dhe

- të rinjtë që i përkasin popullatës së përgjithshme rinore, ku përfshihen të rinjtë që banojnë në zonat kryesore urbane të vendit (në afërsi të qendrave kryesore shëndetësore) dhe që nuk konsiderohen të cenueshëm në bazë të kushteve të renditura më sipër.

Miratimi i këtyre dy kategorive të gjera të të rinjve pjesëmarrës na lejoi që t'i identifikonim ndryshimet në modele midis dy grupeve në analizën vijuese, duke ofruar kështu njohuri se si (dhe cilat) situatat e cenueshmërisë janë faktorë diferencues në përcaktimin e ndikimit të pandemisë Covid-19 në qasje në informata, edukim dhe në shërbimet e ShSR.

Rekrutimi dhe pjesëmarrja e të rinjve në të gjitha fazat e kërkimit u krye në përputhje të plotë me të gjitha konsideratat etike, hulumtuese dhe ligjore, në përputhje me kodin e sjelljes të ESOMAR dhe legjislacionin vendor në përgjithësi, si dhe në lidhje me të drejtat e të rinjve.

- Akterët ekspertë në fushën e ShSR, duke përfshirë ata nga sektori publik, OJQ-të dhe sektori privat, sipas detajeve të theksuara në nën-kapitullin vijues.

Dizajni specifik dhe detajet metodologjike të përdorura për Fazën 2 (hulumtimi cilësor) dhe Fazën 3 (hulumtimi sasior) janë paraqitur më poshtë.

Hulumtimi cilësor në mesin e të rinjve dhe akterëve: Parametrat metodologjikë

U zhvilluan diskutime në fokus grupe me të rinjtë në bazë të një udhëzuesi fleksibil për diskutim të krijuar për t'i adresuar objektivat e hulumtimit. Çdo diskutim në fokus grup:

- U moderua nga një moderator me përvojë në hulumtime me ndihmën dhe përfshirjen aktive të një ose më shumë të rinjve nga ekipi partner lokal, ku të gjithë u trajnuan dhe u informuan mbi objektivat e studimit dhe teknikat e sakta për kryerjen e moderimit;

- U zhvillua në gjuhën lokale pas përkthimit të një udhëzuesi për diskutim që fillimisht ishte hartuar në gjuhën angleze;

- U bazua në një udhëzues për diskutim i cili u rishikua në mënyrë që të ishte relevant për audiencën rinore përpara fillimit të punës në terren;

- Përfshiu pjesëmarrjen e 6–8 të rinjve; dhe

- Zgjati afërsisht 2-2,5 orë.

Përveç kësaj, u kryen intervista të detajuara një-më-një me aktet dhe ekspertët në fushën e ShSR-së, mbi bazën e një udhëzuesi fleksibil për diskutim. Çdo intervistë e detajuar:

- U moderua nga një moderator me përvojë në hulumtime me ndihmën dhe përfshirjen aktive të një ose më shumë të rinjve nga ekipi partner lokal, ku të gjithë u trajnuan dhe u informuan

mbi objektivat e studimit dhe teknikat e sakta për kryerjen e moderimit;

- U zhvillua në gjuhën lokale pas përkthimit të një udhëzuesi për diskutim që fillimisht ishte hartuar në gjuhën angleze;

- Zgjati afërsisht 1-1,5 orë.

Në varësi të karakteristikave specifike të pjesëmarrësve në secilin fokus grup ose intervistë të detajuar, udhëzuesi i diskutimit u përshtat për t'i adresuar plotësisht objektivat përkatëse. Prandaj, edhe pse udhëzuesit e përdorur për diskutim kishin shumë të përbashkëta, u përdorën variante të ndryshme.

Struktura specifike e mostrës dhe numrit të arritur në hulumtimin cilësor ishin si më poshtë.

Diskutimet në fokus grupe me të rinjtë Numri i përgjithshëm i grupeve: 7

Sipas llojit	
1	Popullata e përgjithshme rinore e moshës 18 deri në 30 vjeç në Prishtinë
2	Të rinjtë e moshës 18 deri në 30 vjeç që banojnë në zonat periferike të Podujevës dhe Gjilanit
3	Personat LGBT të moshës 18 deri në 30 vjeç në Prishtinë
4	Vajza dhe gra të reja që ishin shtatzënë ose që kishin lindur gjatë pandemisë Covid-19 në Kaçanik
5	Adoleshentët e moshës 14 deri në 17 vjeç në zonat rurale rreth Prishtinës
6	Vajzat dhe gratë e reja që u përkasin pakicave etnike (rom, ashkali, egjiptian) të moshës 18 deri në 30 vjeç në komunitetet rurale përreth Prishtinës
7	Të rinjtë e komunitetit serb me banim në Gjakovë, Fushë Kosovë dhe Obiliq

Intervista të detajuara me aktet /ekspertët Numri i përgjithshëm i intervistave: 4

Sipas llojit	N°
Ekspert në ShSR, Ministria e Shëndetësisë	1
Mjek në qendrën shëndetësore	1
OJQ në fushën e dhunës seksuale dhe dhuna me bazë gjinore	1
Ekspert i shëndetit mendor në klinikën psikiatrike	1

Studimi sasior tek të rinjtë: Parametrat metodologjikë

Instrumenti i hulumtimit: Pyetësi i strukturuar për plotësim për 10-15 minuta. Pyetësi u administrua në gjuhën lokale, pas përkthimit nga origjinali në gjuhën angleze. Pyetësi u rishikua nga kolegët dhe u pilotua në nivel lokal për të siguruar funksionalitetin, qartësinë dhe ndërlidhjen e tij me audiencën rinore të synuar.

Metodologjia: Kuotat për plotësim u caktuan për grupe specifike të të rinjve me interes, siç theksohet në strukturën e mostrës më poshtë.

Rekrutimi dhe plotësimi i pyetësit: Një kombinim i dy qasjeve është përdorur për rekrutimin e të anketuarve dhe për plotësimin e pyetësit, si më poshtë:

Online: Të anketuarit që i përkasin kategorive të popullsisë së përgjithshme të të rinjve, gratë shtatzëna/nënat e reja, personat LGBT dhe pjesërisht ata në zona të largëta janë ftuar të marrin pjesë përmes email-it. Këto ftesa u shpërndanë përmes

një sërë kanalesh rekrutimi (si të përgjithshme ashtu edhe nëpërmjet organizatave të tjera partnere), për të siguruar rekrutim të mjaftueshëm dhe për të minimizuar paragjykimet në përzgjedhjen e të anketuarve. Të anketuarit pranuan një link me pyetësin, të cilit iu qasën dhe e përdorën për ta plotësuar vetë. Komentet e tyre u dërguan automatikisht në një server qendror për përpunim dhe analizë të mëtejshme të të dhënave.

Intervistimi ballë për ballë: Të anketuarit që banonin në zona të largëta dhe i përkisnin komunitetit etnik rom u rekrutuan qëllimisht përmes bashkëpunimit me personat përgjegjës për këto komuniteteve. Intervistuesit i vizituan këta të anketuar ose në qendër ose në shtëpi dhe u siguruan mjetet teknologjike (një pajisje tablet) për t'u mundësuar të anketuarve ta plotësojnë vetë pyetësin në prani të intervistuesit ose t'u përgjigjen pyetjeve të administruara nga intervistuesi. Edhe këtë herë, përgjigjet u dërguan automatikisht në një server qendror për përpunim dhe analizë të mëtejshme të të dhënave.

Struktura specifike e mostrës dhe numri i arritur në hulumtimin sasior ishin si më poshtë.

Numri total i pyetësorëve

301

Sipas llojit

Popullsia e përgjithshme rinore	100
Të rinjtë në situata të cenueshme: total	201
Në zonat e largëta	62
Rinia e marginalizuar e komunitetit etnik	70
Të rinjtë LGBT	64
Nënat e reja (shtatzëna dhe/ose që kanë lindur gjatë pandemisë Covid-19)	21
Të rinjtë me gjendje të rëndë sociale-ekonomike në qendrat e mëdha urbane	30

Sipas gjinisë

Gjithsej djem/burra	73
Gjithsej vajza/gra	225
Të papërcaktuar	3

Sipas moshës

Të rinjtë (18-30 vjeç)	242
Adoleshentët (14-17 vjeç)	59

E. Qasja analitike dhe kufizimet e hulumtimit

Qasja e mëposhtme analitike është përdorur për secilin nga fazat kryesore të hulumtimit për të siguruar integritetin e të dhënave dhe interpretimin më të saktë të gjetjeve të hulumtimit.

Studimi cilësor (kualitativ): Të dhënat u analizuan në bazë të incizimit të diskutimeve, shënimeve të marra nga moderatorët dhe asistentët hulumtues, dhe përmes një rishikimi të rrjetit të krijuar nga pjesëmarrësit në detyra me karta interaktive. U krye analiza preliminare për çdo diskutim në fokus grup dhe për intervistë të detajuar veçmas, që rezultoi me një raport me komente individuale për secilin. Gjetjet nga të gjitha diskutimet në fokus grupe dhe intervista të detajuara u analizuan për t'i identifikuar temat dhe modelet mbizotëruese në lidhje me objektivat e hulumtimit, duke identifikuar të përbashkëtat dhe dallimet kryesore.

Studimi sasior (kuantitativ) i të rinjve: Të dhënat nga faza sasiore fillimisht u vërtetuan për sa i përket konsistencës së përgjigjeve dhe kontrolleve të kohës për plotësimin e çdo pjese të pyetësorit, në nivel individual të të anketuarve. Pas vërtetimit, të dhënat u analizuan duke përdorur analiza statistikore dydimensionale dhe u bë filtrimi në bazë të profileve të të anketuarve. Prandaj, rezultatet janë analizuar duke përdorur totalitet për popullatën e përgjithshme të të rinjve dhe të rinjtë në situata

të cenueshme veçmas, dhe për secilin nga grupet rinore të cenueshme.

Analiza e integruar: Gjetjet nga dy fazat u analizuan më pas duke përdorur një qasje të integruar 360-shkallë, duke çuar në gjetjet kryesore të përfshira në dokumentin aktual. Të gjitha gjetjet dhe interpretimet e hulumtimit u rishikuan nga hulumtuesit dhe të rinjtë në nivel lokal, për të siguruar përputhjen me interpretimin lokal të rezultateve të marra dhe gjetjeve në përgjithësi.

Kufizimet e kërkimit: Edhe përkundër që hulumtimi i zbatuar përbën një qasje dhe nivel mbulimi shumë gjithëpërfshirës, vihet re se gjetjet i nënshtrohen margjinave statistikore të gabimit që lidhen me numrin e mostrës përfundimtare. Duke qenë në dijeni të kësaj, gjetjet kryesore të raportuara në këtë dokument përfshijnë vetëm ato që janë konfirmuar nga faza cilësore dhe sasiore e hulumtimit.

Hulumtimet e ardhshme: Si përfundim, ndërkohë që hulumtimi ofron informata dhe rekomandime të vlefshme, vetë gjetjet tregojnë nevojën për hulumtime të mëtejshme mbarëkombëtare në shkallë të gjerë midis të rinjve, të cilat më së miri do të kryeshin sapo të vërehen efektet e mbetura të pandemisë, pra pasi pandemia të kalojë në një fazë endemike afatgjatë.

F. Gjetjet kryesore

1. Kërkimi i informatave dhe qasja në informata mbi shëndetin seksual dhe riprodhues

1.1 Aspektet e përgjithshme që ndikojnë në përfshirjen e të rinjve në çështjet e ShDSR

Një sërë problemesh të kaluara dhe aktuale ndërlidhen me përfshirjen e të rinjve në çështjet e ShDSR dhe gjithashtu natyrën e aktiviteteve të ndërmarra si reagim ndaj pandemisë Covid-19. Për shembull, **mungesa në të kaluarën e ndonjë edukimi kuptimplotë seksual** zvogëlon kapacitetin e të rinjve për të zhvilluar një bazë të fortë njohurish mbi aspektet që lidhen me ShDSR.

Organizatat ndërkombëtare luajnë një rol shumë të fuqishëm në Kosovë: gjatë pandemisë këto organizata reagojnë dhe bashkëpunuan me OJQ-të lokale për të ofruar shërbime dhe mbështetje për grupet më të cenueshme. Në thelb, duket se aktivitetet lokale kryesisht varen nga organizatat ndërkombëtare për sa i përket mbështetjes financiare dhe ndihmës me burime. Ndonëse kjo është pozitive në aspektin praktik, duket se i liron institucionet vendore nga detyrimi për t'i marrë nën përgjegjësinë e tyre çështjet e ShDSR. Kjo situatë reflektohet gjithashtu edhe tek **mbështetja e konsiderueshme në burimet 'e jashtme' të informacionit, të cilat shihen si më të besueshme se burimet lokale**, siç është faqja e internetit e

Organizatës Botërore të Shëndetësisë, dhe - në mesin e komunitetit serb - burime informacioni nga Serbia.

Shoqëria, duke përfshirë të rinjtë, mbetet shumë patriarkale, që do të thotë se **çështjet që kanë të bëjnë me ShSR mbeten tabu**. Në këtë mënyrë, ndërkohë që ekziston nevoja për informata lidhur me ShSR, këto nevoja nuk përkthehen në veprime për kërkimin e informatave tek një pjesë e konsiderueshme e popullatës rinore.

Në rastet më ekstreme, anëtarët e **komunitetit të margjinalizuar rom** konsiderojnë se problemet e ShSR **mund të zgjidhen individualisht** dhe preferojnë ta bëjnë këtë, për të shmangur problemet që lidhen me kontrollin patriarkal brenda familjes dhe qëndrimet paragjyquese të profesionistëve shëndetësorë.

Ekziston një dallim i qartë në mundësinë për ofrimin e shërbimeve të ShSR dhe në rrezikun e ekspozimit ndaj incidenteve të dhunës ndërmjet popullatës së përgjithshme rinore dhe atyre në situata të cenueshme (veçanërisht atyre që i përkasin komuniteteve të margjinalizuara etnike të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve).

1.2 Ndikimi i përgjithshëm i pandemisë Covid-19 në kërkimin e informatave dhe qasjen në temat e ShDSR

Në përgjithësi, si të rinjtë ashtu edhe personat e cenuar raportojnë një tendencë se kanë qenë të

preokupuar me çështje të tjera, më të rëndësishme se kërkimi i informacionit ose shërbimeve të ShDSR (përkatësisht 40% dhe 41%). Në të njëjtën kohë, vihet re se pak më shumë se një në pesë të rinj të anketuar raportuan se nuk dinin se ku të kërkonin informacione mbi ShDSR, duke sugjeruar se kjo gjë nuk ka qenë pengesë e madhe për kërkimin e informacioneve.

Perceptimet mbi kërkimin e informacionit për ShSR - popullata e përgjithshme e të rinjve (% e përmendur)

Gjatë pandemisë, nuk dija ku të kërkoja informacione mbi shëndetin seksual, seksualitetin ose marrëdhëniet



Gjatë pandemisë, unë isha i/e preokupuar me probleme të tjera më të rëndësishme sesa kërkimi i informacioneve ose shërbimeve të ShDSR



-të rinjtë në situata të cenueshme (% e përmendur)

Gjatë pandemisë, nuk dija ku të kërkoja informacione mbi shëndetin seksual, seksualitetin ose marrëdhëniet



Gjatë pandemisë, unë isha i/e preokupuar me probleme të tjera më të rëndësishme sesa kërkimi i informacioneve ose shërbimeve të ShDSR



■ Pajtohem ■ Nuk pajtohem ■ Nuk kam mendim ■ Nuk e di

Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

1.3 Kërkimi i informatave dhe nevojat për ShDSR gjatë pandemisë


Përqindje të ngjashme të popullsisë së përgjithshme të të rinjve (50%) dhe atyre në situata të cenueshme (51%) kanë kërkuar të paktën një lloj informacioni mbi ShDSR gjatë pandemisë Covid-19. Për të dyja këto kategori të përgjithshme të të rinjve, shëndeti mendor dhe mirëqenia psikologjike ka qenë tema kryesore e kërkimit (përkatësisht 32% dhe 40%), ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme e të rinjve

kanë qenë gjithashtu të interesuar të mësojnë për çështje gjinekologjike.

Një përqindje dukshëm më e madhe e të rinjve në situata të cenueshme përmendën kërkimin e informacionit për çështje që lidhen me dhunën në familje ose nga partneri intim, ndërkohë që ka pasur interes edhe për çështjet e planifikimit familjar si shtatzënia, lindja dhe përkujdesja pas lindjes, dhe në planifikimin ose vendimmarrjen për të pasur fëmijë.

Kërkimi i informacionit mbi ShSR gjatë pandemisë Covid-19 (% që kërkon informacion)

■ Të rinjtë në situata të cenueshme ■ Popullsia e përgjithshme rinore



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)


Informacioni mbi **shëndetin mendor dhe mirëqenien psikologjike** ka qenë veçanërisht i rëndësishëm për të rinjtë me status më të ulët socio-ekonomik që banojnë në zonat urbane, të rinjtë e grupeve të marginalizuara etnike (romë, ashkali dhe egjiptianë) dhe personat LGBT.

Në lidhje me **komunitetin LGBT** në veçanti, komentet cilësore të ofruara gjatë diskutimeve në fokus grupe treguan se nevoja për mbështetje për shëndetin mendor lidhet fuqishëm me konfuzionin e përhapur (veçanërisht gjatë muajve të parë të pandemisë Covid-19) në lidhje me besimin e rremë se virusi mund të ndikojë në shëndetin fizik të personave LGBT më shumë se të tjerëve. Mungesa e institucioneve klinike (të hapura) ose gatishmëria

për t'u fokusuar në nevojat dhe pyetjet e tyre specifike ka thelluar dukshëm konfuzionin e tyre.

Informatat në lidhje me **dhunën me bazë gjinore** në përgjithësi, por edhe në lidhje me mesazh seksual ose përvojat seksuale në internet, kanë pasur një rëndësi dukshëm më të madhe tek të rinjtë e grupeve të marginalizuara etnike, duke reflektuar ndoshta një incidencë më të lartë të dëshimit ose përjetimit të dhunës si para ashtu edhe gjatë periudhës së Covid-19. Në këtë kontekst, grupet etnike të marginalizuara kanë qenë gjithashtu më të prirura për të kërkuar informacione të përgjithshme mbi marrëdhëniet seksuale ose intime gjatë pandemisë.

Kërkimi i informacionit mbi ShSR gjatë pandemisë Covid-19 (% që kërkon informacion)




Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

Kërkimi i informacioneve mbi çështjet e shëndetit gjinekologjik ka qenë më i shpeshti tek të rinjtë e zonave urbane me status më të ulët socio-ekonomik. Megjithatë numër më i vogël i personave LGBT kanë kërkuar informacione mbi shëndetin gjinekologjik,

diskutimi cilësor në fokus grupe me personat LGBT zbuloi shqetësim të veçantë se si vaksinimi Covid-19 mund të ndikojë në veçanti tek burrat dhe gratë trans që po i nënshtrohen terapisë hormonale, duke çuar në një nivel të lartë të ankthit dhe pasigurisë.


Kërkimi i informacionit mbi ShSR gjatë pandemisë Covid-19 (% që kërkon informacion)



Çështjet që lidhen me shtatzëninë kanë qenë— ashtu siç është pritur—fusha kryesore e kërkimit të informacionit tek nënat e reja, por edhe tek të rinjtë me status më të ulët socio-ekonomik në zonat urbane. Dëshmitë nga diskutimet cilësore në fokus

grupe konfirmuan më tej se gratë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë kërkuar informacione se si virusi Covid-19 mund të ndikojë në shtatzëninë, fertilitetin dhe ciklin e tyre menstrual.

Kërkimi i informacionit mbi ShSR gjatë pandemisë Covid-19 (% që kërkon informacion)



Përveç kërkimit të informacionit të lartpërmendur, vihet re se **shumë adoleshentë** iu referuan gjatë diskutimeve në fokus grupe rëndësisë së **të pasurit informacione për IST** dhe si mund të ndikojë Covid-19 në mbrojtjen nga këto infeksione. Megjithatë, kjo nevojë themelore duket se nuk është përkthyer në kërkim aktiv për informacione mbi këtë temë, për shkak të mungesës së njohurive se ku duhet kërkuar informatat, gjë që edhe është rezultat i mungesës totale të edukimit seksual në mjedisin emergjent në internet dhe atë shkollor, si dhe nga ndjenja e rrënjësor ndër vite e turpit për të diskutuar çështjet e tilla nga ana e vetë pedagogëve.

“Mësuesi ka turp të flasë për seksin në shkollë.”

-Një i ri në Prishtinë

1.4 Pengesat e përgjithshme për kërkimin e informacionit

Kërkimi i informacionit për çështjet e ShDSR është një temë që shpërfaqti një sërë pengesash themelore gjatë diskutimeve cilësore të fokus grupeve me të rinjtë dhe intervistave të detajuara me ekspertë, të cilat duket se jo vetëm që janë pengesa por edhe dekurajojnë të rinjtë që të kërkojnë informacione në mënyrë aktive. Këto pengesa kanë të bëjnë me:

- **Mungesën e informatave në të gjitha gjuhët:** anëtarët e grupet të pakicave etnike si komuniteti serb raportojnë një pengesë të atillë që informacioni është kryesisht në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe;
- **Mungesa e informacionit të përhapur përmes kanaleve tradicionale të medias si TV ose radio:** prandaj të rinjtë duhet të mbështeten në burimet online, dhe kështu krijohet një problem për ata në zonat e largëta rurale pa qasje në internet; dhe
- **Mungesa e ndërgjegjësimit për problemet e ShDSR që mund të lindin gjatë dhe për shkak të izolimit:** siç theksohet nga një psikiatër profesionist, ka pasur një mungesë vlerësimi dhe konsiderate për mënyrën se si **sjelljet seksuale mund të ndryshojnë** në përgjithësi, gjë që ka të ngjarë të ndikojë në ndryshimin e nevojave për informacione në të gjithë gamën e temave të ShDSR.

1.5 Nevojat e reja për informacione dhe urgjenca për to gjatë pandemisë Covid-19

1.5.1 Urgjenca e përgjithshme për informim mbi ShDSR


Pengesat themelore për kërkimin e informacionit mbi ShDSR që u përmendën më sipër reflektohen në një përqindje relativisht të ulët të popullsisë totale të të rinjve që theksojnë se tema specifike të informimit janë bërë më urgjente gjatë Covid-19. Kështu, duket se për një pjesë të konsiderueshme të audiencës rinore, përjashtimi nga sfera e kërkimit të informacioneve është thelluar gjatë pandemisë Covid-19.

Megjithatë, në përgjithësi, **shëndeti mendor dhe mirëqenia psikologjike** spikat qartë si tema kryesore që ka fituar rëndësi për një pjesë të konsiderueshme të të rinjve (26% e të rinjve në përgjithësi dhe 30% e atyre në situata të cenueshme). Informacioni mbi shëndetin mendor është bërë më i rëndësishëm veçanërisht për të rinjtë e zonave urbane me status më të ulët socio-ekonomik (53%) dhe personat LGBT (34%).

Shtatzënia, lindja dhe përkujdesja pas lindjes (siç edhe është pritur) kanë pasur rëndësi më të madhe për 52% të nënave të reja.

Informacionet mbi ShSR që u bënë MË URGJENTE gjatë pandemisë Covid-19 -për të gjithë të rinjtë (% e përmendur)

■ Të rinjtë në situata të cenueshme ■ Popullsia e përgjithshme rinore



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)


1.5.2 Urgjenca e informimit mbi ShDSR për të rinjtë që kërkojnë informacione

Megjithatë, analiza krahasuese midis atyre që në të vërtetë kërkuan informacione për tema specifike

sugjeron se në pothuajse të gjitha temat e ShDSR, urgjenca e informimit është rritur, siç tregohet më poshtë:

Informacionet mbi ShSR që u bënë MË URGJENTE gjatë pandemisë Covid-19 - për ata që kërkojnë informacione (% e përmendur)

■ Të rinjtë në situata të cenueshme ■ Popullsia e përgjithshme rinore



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

Prandaj, duket se midis atyre që janë të përfshirë në mënyrë aktive në kërkimin e informacionit mbi SHDSR, është e dukshme një urgjencë më e madhe, veçanërisht në lidhje me:

- Shëndetin mendor, dhunën në familje dhe shëndetin e përgjithshëm tek të gjithë të anketuarit;
- Çështjet që lidhen me ndërprerjen e shtatzënisë për rininë në përgjithësi; dhe

- Praktikimi i seksit të sigurt tek të gjithët të rinjtë e anketuar. Adoleshentët u përqendruan në diskutimet e grupeve të fokusit se si virusi Covid-19 ndikon në mundësinë e të pasurit 'marrëdhënie të mbrojtura ose të sigurta' karshi IST-ve. Kjo lidhet përsëri me stresin shtesë që ata e kanë ndjerë në lidhje me sigurinë kur vie puna te të pasurit kontakte intime.



1.6 Kanalet e informimit mbi ShSR gjatë pandemisë Covid-19

1.6.1 Popullsia e përgjithshme rinore


Kanalet e informimit të përdorura nga popullata e përgjithshme rinore tregojnë zhvendosje të dukshme kolektive drejt përdorimit të kanaleve online (media sociale, faqe interneti, blogje ose aplikacione), si dhe një mbështetje më të fortë tek miqtë ose bashkëmoshatarët. Diskutimet në fokus grupe zbuluan se të rinjtë në mjediset urbane që nuk kanë kërkuar informacione për ShSR në internet ose nuk kanë interes për të kërkuar informacione të tilla ose nuk kanë besim në kredibilitetin e burimeve në internet.

Është interesante se ka më pak besim (krahasuar me periudhën para pandemisë) në programet tradicionale televizive dhe radiofonike dhe mjedisin shkollor, por edhe në psikologët, gjë që me shumë gjasa reflekton faktin që pandemia Covid-19 ka zënë vendin kryesor në raportimin mediatik dhe ka kufizuar qasjen në burime të tilla gjatë pandemisë.

Ekspertët e intervistuar u pajtuan se të rinjtë janë larguar nga media tradicionale televizive, duke theksuar se pavarësisht qasjes së gjerë në TV si medium, raportimi në TV ka qenë joprofesional, joshkencor dhe me cilësi të ulët për sa i përket dobisë edukative për adoleshentët.

Kanalet e informimit për ShSR të përdorura PARA dhe GJATË pandemisë Covid-19 - popullsia e përgjithshme rinore (% e përmendur)

■ Pas pandemisë ■ Para pandemisë



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

1.6.2 Të rinjtë në situata të cenueshme

Tek të rinjtë në situata cenueshme, vihet re rritje e kërkesës për **informata nga familjarët apo farmacistët e besueshëm**.

Në të njëjtën kohë, është i dukshëm një nivel i lartë i mbështetjes në burimet e rrjeteve sociale, në nivele të ngjashme si para pandemisë. Reagimet gjatë diskutimeve në fokus grupe sugjeruan se mbështetja në burimet e internetit tek të rinjtë në situata më të cenueshme ka qenë e zakonshme veçanërisht për **nënat e reja dhe/ose gratë shtatzëna**, si dhe gratë me origjinë serbe, të cilat kërkimin e informacionit në internet e kanë kryer dhe përcjellur me biseda telefonike dhe shkëmbime me e-mail me mjekët e tyre; në këtë kontekst, gratë serbe raportuan se përdornin burime online që buronin nga Serbia, për shkak të gjuhës dhe nivelit më të madh të besimit në burime.

Në anën tjetër, gratë nga grupet etnike të marginalizuara si romë, egjiptian apo ashkali, edhe


pse pjesërisht kanë përdorur mjete online, zakonisht i referoheshin jokredibilitetit në një informacion të tillë, duke e konsideruar atë si një burim të fundit në mungesë të qasjes në burime të tjera të besueshme informacioni.

Për sa i përket përdorimit të **OJQ-ve** për informacion, rritja është mjaft domethënëse, por në një nivel të ulët (nga 7% para pandemisë në 10% gjatë pandemisë). Diskutimet në fokus grupe shpërfaqën një mungesë të dukshme të njohurive për OJQ-të si burim potencial informacioni, edhe pse siç u zbulua edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit OJQ-të kanë qenë aktive në këtë drejtim:

- Në mesin e grave serbe duke mbështetur viktimat e dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore; dhe
- Në mesin e adoleshentëve dhe personave LGBT duke ofruar trajnime joformale mbi edukimin dhe shërbimet seksuale.

Kanalet e informimit për ShSR të përdorura PARA dhe GJATË pandemisë Covid-19 - të rinjtë në situata të cenueshme (% e përmendur)

■ Pas pandemisë ■ Para pandemisë



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

1.7 Kanalet e informimit në të cilat u rrit mbështetja gjatë pandemisë Covid-19


Është e qartë se ata të rinj që kishin përdorur kanale të ndryshme për të marrë informacione për ShSR edhe para pandemisë Covid-19, mbështeteshin më shumë në kanalet e rrjeteve sociale dhe faqet e internetit gjatë pandemisë. Kërkimi në internet u raportua në diskutimet në fokus grupe si i ndërlidhur me kërkimin e informacionit të besueshëm për tema specifike si qendrat e kujdesit shëndetësor publik, psikologët dhe gjinekologët.

Në këtë kontekst, u theksua se u rrit rëndësia e faqeve të internetit të **institucioneve, organizatave**

dhe OJQ-ve, ndonëse pjesëmarrësit e diskutimeve në fokus grupe kishin vështirësi në njohjen ose emërtimin e ndonjë faqeje specifike interneti. Megjithatë, të rinjtë raportuan se kur kërkonin informacione të besueshme në internet, janë mbështetur më së shumti në burime jashtë Kosovës, veçanërisht nga Shqipëria, Serbia dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (i vetmi burim ndërkombëtar që u përmend si pozitiv).

Miqtë dhe bashkëmoshatarët por edhe punonjësit shëndetësor në komunitet kanë pasur gjithashtu rëndësi më të madhe për ata që më parë i kanë përdorur burimet e tilla për të kërkuar informacione mbi ShSR.

Kanalet e informimit në të cilat të rinjtë kanë pasur më shumë besim gjatë pandemisë - që e kanë përdorur më parë secilin kanal (% e përmendur)




Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

1.8 Përdorimi i teknologjisë për kërkimin e informacioneve gjatë pandemisë Covid-19

Kufizimet në qasjen në teknologji ose internet nuk duket se kanë qenë pengesë për kërkim të informacioneve për të rinjtë në përgjithësi.

Teknologjia në dispozicion: Doja të përdorja internetin, por nuk kisha qasje ose pajisjet e nevojshme (% e përmendur)



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

Megjithatë, pjesëmarrësit e diskutimit në fokus grup përmendën një sërë kufizimesh në lidhje me përdorimin e teknologjisë dhe kanaleve online për të kërkuar informacione për ShSR gjatë pandemisë Covid-19.

Për shembull, **personat LGBT** thanë se nevojitej një **nivel i lartë i njohurive digjitale** për t'i përdorur siç duhet makinat e kërkimit dhe për të marrë informacione të sakta nga faqet e internetit, veçanërisht duke pasur parasysh vëllimin e madh të informacioneve konfuze dhe jokredibile që ishin në dispozicion.

Të rinjtë nga zonat rurale raportuan se kishin përjetuar bullizëm kibernetik gjatë përdorimit të rrjeteve sociale. Ata e perceptuan dhe raportuan këtë si një **formë dhune**, e cila përfshinte ngacmimin seksual në internet përmes rrjeteve sociale, ku njerëzit dërgonin fotografi të papërshtatshme ose përfshiheshin në forma të tjera të bullizmit kibernetik si ngacmimi, kur flisnin për probleme që lidhen me ShSR.

Adoleshentët gjithashtu raportuan se kishin përjetuar bullizëm kibernetik gjatë kërkimit të informacioneve për ShDSR në internet: ata deklaruan qartë se sa herë që përpiqeshin të kërkonin informacione ose të pyesnin njerëzit në internet për shëndetin seksual gjatë pandemisë, kjo rezultonte në bullizëm kibernetik dhe shkelje të privatësisë së tyre.

Për më tepër, gjatë intervistave të detajuara, profesionistët shëndetësorë iu referuan rreziqeve të përdorimit të teknologjisë/burimeve në internet, si p.sh. të rinjtë që marrin informacione

mbi seksualitetin në mënyrën më të ashpër të mundshme përmes pornografisë, për shkak të kuriozitetit dhe presionit të bashkëmohatarëve të tyre, gjë që mund të çojë në marrëdhënie seksuale dhe frustrime të përgjithshme.

1.9 Keqinformimi gjatë pandemisë Covid-19

Pjesëmarrësit e diskutimeve në fokus grupe thanë se për shkak të sasisë së informacionit për Covid-19 në përgjithësi dhe për ShDSR më konkretisht, ata nuk mund ta bënë dallimin midis informacioneve të besueshme dhe atyre jo të besueshme. Kjo krijoi një mungesë të përgjithshme besimi në informacionet që i gjenin. Për më tepër, si përmes rrjeteve sociale ashtu edhe për shkak të natyrës patriarkale të shoqërisë, kanë qarkulluar norma, stereotipe, mite të ndryshme dhe dezinformata, si për shembull në lidhje me ndikimin e Covid-19 tek:

- Personat LGBT (njëlloj si HIV);
- Fertiliteti mashkullor; dhe
- Shëndeti i fetusit; dhe

“Kishte disa lajme që homoseksualët nuk mund të infekttoheshin dhe Covid-19 u krahasua aq shumë me HIV-in. HIV njihej si virusi i homoseksualëve, kështu që ekzistonte frika që Covid-19 do të konsiderohej si faj i homoseksualëve. Të tilla postime kishte në Facebook.”

- Person nga komuniteti LGBT

- Dezinformatata mbi shtrirjen e vetë pandemisë.

“Institucionet gënjejnë për numrin e rasteve të infektuara.”

-Një femër që ishte shtatzënë dhe që kishte lindur gjatë pandemisë Covid-19


1.10 Informacioni i nevojshëm për ShDSR që ishte i paqasshëm gjatë pandemisë Covid-19

1.10.1 Kufizimet e përgjithshme në gjetjen e informacionit të nevojshëm mbi ShDSR

Në mesin e të gjithë të rinjve të anketuar, informacioni mbi shëndetin mendor është tema kryesore që ka qenë e nevojshme, por që nuk mund të gjendej në mënyrë adekuate, veçanërisht në mesin e të rinjve me status më të ulët socio-ekonomik (37% nuk ishin në gjendje t’i qaseshin informacioneve për shëndetin mendor).

Informacionet mbi ShSR që NUK MUND TË MERRESHIN gjatë pandemisë Covid-19 (% e përmendur)

■ Të rinjtë në situata të cenueshme ■ Popullsia e përgjithshme rinore



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)


Megjithatë, në mesin e atyre që kërkojnë në mënyrë aktive për informacione specifike, një pjesë e konsiderueshme e të rinjve (si të rinjtë në përgjithësi ashtu edhe ata në situata të cenueshme) nuk kanë qenë në gjendje të marrin informacione për tema të ndryshme. Gjatë diskutimeve në fokus grupe, pjesëmarrësit raportuan se kësaj i kishte kontribuar edhe mungesa e përgjithshme e besimit në informacionet në dispozicion që ofroheshin nga qeveria dhe/ose institucionet lokale shëndetësore, ndërkohë që duket se ka pasur edhe barriera të dukshme gjuhësore për disa.

Në këtë kontekst, mungesat kryesore për sa i përket informatave – siç tregohet më poshtë – kanë të bëjnë me:

- Ndërprerjen e shtatzënisë/abortit dhe shtatzënisë (tek të rinjtë në përgjithësi);
- Dhunën me bazë gjinore;
- Terapinë për afirmim gjinor dhe orientimin seksual (personat LGBT);
- IST dhe praktikimin e seksit të sigurt (të rinjtë në situata të cenueshme); dhe
- Planifikimi familjar (të rinjtë në situata të cenueshme).

Përqindja e atyre që kishin nevojë për informacione por që NUK mund t'i merrnin gjatë pandemisë Covid-19 (% e përmendur)

■ Të rinjtë në situata të cenueshme ■ Popullsia e përgjithshme rinore



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)


1.10.2 Kufizimet e kanaleve për gjetjen e informacionit të nevojshëm mbi ShDSR

Të rinjtë në situata të cenueshme iu referuan një game të gjerë kanalesh si problematike në dhënien

e informacioneve të nevojshme, veçanërisht atyre lidhur me edukimin seksual, organizatat e komunitetit lokal, psikologët dhe farmacistët në veçanti.

Kanalet nga të cilat ishte e PAMUNDUR ose E VËSHTIRË marrja e informacionit të kërkuar - të rinjtë në situata të cenueshme (% e përmendur)

■ % e atyre që kërkonin informata ■ % e audiencës totale




Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

Në mesin e popullatës së përgjithshme të të rinjve, kufizimet e kanaleve për sa i përket dhënies së informacionit të kërkuar janë më pak të theksuara,

megjithëse përsëri mësuesit, edukimi seksual dhe mjedisi arsimor u përmendën si kanalet kryesore problematike në këtë drejtim.

Kanalet nga të cilat ishte e PAMUNDUR ose E VËSHTIRË marrja e informacionit të kërkuar - popullata e përgjithshme rinore (% e përmendur)

■ % e atyre që kërkonin informata ■ % e audiencës totale



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

Në të vërtetë, komentet nga adoleshentët gjatë diskutimeve në fokus grupe theksuan shkallën dhe natyrën e problemeve që kanë të bëjnë me edukimin joadekuat seksual, si para ashtu edhe gjatë pandemisë. Adoleshentët nga zonat rurale besojnë se temat e mëposhtme duhet të përfshihen në kurrikulën formale të edukimit seksual në shkolla:

- Të gjitha sëmundjet që lidhen me ShSR;
- Komplikimet gjatë marrëdhënieve seksuale;
- Mbrojtja gjatë marrëdhënieve seksuale dhe pasojat e mundshme;

- Simptomat e IST;
- Çështjet e pëlqimit dhe të qenit të vetëdijshëm se mund ta padisni partnerin tuaj nëse ai/ajo ju detyron të kryeni marrëdhënie seksuale me të; dhe
- Ngritja e vetëdijes lidhur me faktin se nuk duhet të filloni një lidhje apo të martoheni me një person thjesht sepse keni pasur marrëdhënie seksuale me të.

Në të njëjtën kohë, adoleshentët e kuptuan dhe dukej se e pranonin se mësimdhënësit nuk do të donin të flisnin për ShDSR dhe se në shumicën e

rasteve këto lëndë do të injoroheshin ose, në rastet më të këqija, mësime të mëdha do t'i turpëronin anëtarët e klasës që nuk kanë informata themelore që kanë të bëjë, për shembull, me shtatzëni. Kjo paraqet një problem më të gjerë që shtrihet në qëndrimet e edukatorëve. Në këtë kontekst, edukimi joformal aktualisht shihet si më i dobishëm për adoleshentët dhe preferohet në vend të edukimit seksual në shkollë, sepse shihet si më e përshtatshme për ta që t'i mbajnë këto orë jashtë shkollës dhe në një mjedis të caktuar.

Vetë profesionistët i përsëritën këto mendime në lidhje me qëndrimin e edukatorëve:

“Mësime të mëdha e kanë të vështirë për të folur për këto tema; prandaj, ata thjesht e kalojnë atë mësim.”

- Një psikiatër, klinika psikiatrike në Qendrën Klinike Universitare

Problemet e sipërpërmendura në lidhje me edukatorët perceptohen nga adoleshentët si rrjedhojë e mungesës së seriozitetit për fokusim në edukimin seksual nga ana e shtetit:

“Mësime të mëdha punësohen, por ne prapë mbetemi pa informacionin e nevojshëm.”

“Kosova nuk ka program për edukim mbi shëndetin seksual dhe mendor. Qeverisë nuk i intereson edukimi mbi shëndetin seksual dhe mendor.”

- Adoleshentët



II. Qasja në shërbimet e ShSR

2.1 Perceptimet e përgjithshme për qasjen dhe ofrimin e shërbimeve ShSR

Si popullata e përgjithshme rinore, ashtu edhe ata në situata të cenueshme shprehën qëndrime shumë të forta se pandemia:


- Ka treguar se sa e rëndësishme është të kesh një **doktor të besueshëm të familjes** (kjo është theksuar nga 71% e popullsisë së përgjithshme rinore dhe 63% e të rinjve në situata të cenueshme);

- Ka bërë që **nevoja për ofrimin e edukimit seksual të vihet në pah** (53% e popullsisë së përgjithshme rinore dhe 42% e të rinjve në situata të cenueshme); dhe


- Ka vënë në pah se **shërbimet e ShDSR nuk i plotësojnë në mënyrë adekuate nevojat e të rinjve** (41% e popullsisë së përgjithshme rinore dhe 35% e të rinjve në situata të cenueshme).

Për më tepër, një pjesë e madhe (48%) e adoleshentëve në situata të cenueshme besojnë se për të marrë vëmendjen e nevojshme kur kërkojnë shërbime ShDSR, duhet të paraqiten së bashku me prindërit e tyre.

Perceptimet e shërbimeve të ShSR - popullsia e përgjithshme rinore (% e përmendur)



- të rinjtë në situata të cenueshme (% e përmendur)




■ Pajtohem ■ Nuk pajtohem ■ Nuk kam mendim ■ Nuk e di

2.2 Shërbimet dhe produktet e nevojshme të ShDSR gjatë pandemisë Covid-19

Diskutimet cilësore në fokus grupe treguan se ekziston një perceptim se përpjekjet për t'i adresuar problemet e pandemisë Covid-19 kanë dominuar ndaj të gjitha problemeve tjera shëndetësore në përgjithësi dhe se situata nuk ka ndikuar në nevojat e përgjithshme të të rinjve për ShSR. Rrjedhimisht, nuk duket se ka pasur ndonjë ndryshim të madh në nevojën për qasje në shërbime gjatë pandemisë. Megjithatë, është e qartë se kategoritë e mëposhtme të të rinjve kanë pasur kërkesa specifike për sa i përket qasjes në shërbimet/produktet e ShDSR:


- Produkte të higjienës menstruale për tërë gjininë femërore;
- Këshillim në lidhje me seksualitetin dhe/ose marrëdhëniet për të rinjtë në situata të cenueshme, dhe veçanërisht për grupet etnike të marginalizuara (24%) dhe nënat e reja (19%);
- Këshillim për planifikimin familjar për të rinjtë në situata të cenueshme dhe veçanërisht për personat LGBT (20%) dhe nënat e reja (38%); dhe
- Kontrollë gjinekologjike, analiza apo konsulta, veçanërisht për nënat e reja (48%).



Shërbimet e nevojshme të ShSR gjatë pandemisë Covid-19 (% e përmendur)

■ Të rinjtë në situata të cenueshme

■ Popullata e përgjithshme rinore




Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

2.3 Përvojat pozitive lidhur me qasjen në shërbimet e ShSR gjatë pandemisë Covid-19

Praktikisht, nga diskutimet e fokus grupeve me të rinjtë nuk pati ndonjë deklaratë spontane pozitive në lidhje me qasjen në shërbimet ShSR gjatë pandemisë Covid-19. Megjithatë, nënat e reja

theksuan se gratë shtatzëna kanë pasur prioritet në qendrat e kujdesit shëndetësor, spitale dhe klinika. Në të vërtetë, kjo konfirmohet kryesisht nga nënat e reja përmes matjeve sasiore, ashtu siç përshkruhet më poshtë, me informatat dhe shërbimet të cilat vlerësohen shumë. Nga të gjithë parametrat e vlerësuar, nënat e reja shprehnin nivelin më të ulët të kënaqshmërisë me mbështetjen psikologjike që u ishte ofruar.

Niveli i kënaqshmërisë me shërbime për nënat e reja gjatë pandemisë Covid-19 (% e përmendur)




2.4 Vështirësitë për qasje në shërbimet dhe produktet e ShDSR gjatë pandemisë Covid-19

2.4.1 Vështirësitë për qasje në shërbimet e ShDSR gjatë pandemisë Covid-19 tek të rinjtë

Në përgjithësi, përqindja e të rinjve që raportojnë vështirësi për qasje në shërbime/produkte të ShDSR duket e kufizuar, siç tregohet si përmes matjeve sasiore ashtu edhe gjatë diskutimeve në fokus grupe.

Vështirësi në qasje në shërbime gjatë pandemisë Covid-19 - të gjithë të rinjtë (% e përmendur)



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

Për më tepër, është e qartë se përqindja e të rinjve që janë përballur me vështirësi në qasjen e shërbimeve për herë të parë gjatë pandemisë Covid-19 (d.m.th. që nuk janë përballur me këto vështirësi para pandemisë) është shumë e vogël, si më poshtë:

- 2% e të gjithë të rinjve për sa i përket qasjes në këshillim për seksualitetin dhe marrëdhëniet;
- 3% e të rinjve në situata të cenueshme për sa i përket çfarëdo lloji kontrolli gjinekologjik;
- 2% e të rinjve në situata të cenueshme për sa i përket qasjes në shërbime të këshillimit familjar; dhe
- 2% e të rinjve në situata të cenueshme për sa i përket kontrolleve rutinore në lidhje me ShSR.

2.4.2 Vështirësitë në qasjen e shërbimeve të ShDSR gjatë pandemisë Covid-19 tek të rinjtë me nevoja specifike për shërbime

Megjithatë, në mesin e atyre të rinjve që kanë kërkuar në mënyrë specifike të kenë qasje në shërbimet e ShSR, një pjesë e konsiderueshme nuk kanë qenë në gjendje ta arrijnë këtë pa u përballur me vështirësi, pra:

- 50% e popullatës së përgjithshme rinore dhe 50% e të rinjve në situata të cenueshme që kanë pasur nevojë për kontrolla gjinekologjik;
- 45% e të rinjve në përgjithësi dhe 38% e të rinjve në situata të cenueshme që kanë pasur nevojë për këshillim për seksualitetin dhe/ose marrëdhëniet;
- 33% e të rinjve që kanë pasur nevojë për prezervativë; dhe
- 6% e të rinjve në përgjithësi dhe 6% e të rinjve në situata të cenueshme që kanë pasur nevojë për produkte të higjienës menstruale.

2.4.3 Problemet e cilësisë gjatë qasjes në shërbimet e ShSR

Pavarësisht nga ndikimi i kufizuar në qasjen në shërbimet e ShSR, janë evidente një sërë problemesh dhe pengesash të mëtejshme specifike për qasjen e shërbimeve të ShSR, të identifikuar kryesisht përmes hulumtimeve të mëtejshme gjatë diskutimeve në fokus grupe me të rinjtë dhe gjatë

intervistave të detajuara me ekspertë. Prandaj, problemet e theksuara më poshtë janë pengesa të fshehura për qasjen në shërbimet e ShSR, gjë që nënkupton se qasja në shërbime shpesh kufizohet në një fazë shumë të hershme për sa i përket dekurajimit të të rinjve nga përpjekjet për marrjen e shërbimeve (pra, të rinjtë kërkonin shërbime të tilla vetëm kur e dinin se mund t'u qasen me lehtësi atyre).

Popullsia e përgjithshme rinore përmendi relativisht pak nevojën për të kërkuar shërbime të ShSR, si dhe theksuan se nuk ndihen rehat kur kërkojnë shërbime të ShDSR nga mjekët dhe ndjehen të dekurajuar nga kërkimi i shërbimeve:

“Nuk e di pse, por mendoj që nëse do të shkoja te mjeku për të folur për ShDSR kur isha 16 vjeç, me siguri do të më thoshte: “Je shumë i ri për këto gjëra.”

- Një i ri nga Prishtina

Në anën tjetër, të rinjtë në zonat rurale raportuan probleme të rëndësishme në qasjen në shërbime të ShSR, të tilla si:

- E panë se punonjësit e kujdesit shëndetësor ishin kryesisht të zënë me rastet e Covid-19 dhe kishin kohë të kufizuar për konsultime mbi ShSR apo edhe për takime dhe kontrolle gjinekologjike;
- E kuptuan që punonjësve shëndetësorë u ishin bartur përgjegjësi të tjera të menaxhimit të situatës me Covid-19, duke krijuar kështu problem për sa i përket stafit në dispozicion;
- Theksuan se disa klinika dhe qendra shëndetësore ishin të mbyllura për një periudhë të gjatë kohore për shkak të masave parandaluese Covid-19, duke e bërë të vështirë qasjen në shërbimet e nevojshme. Në fakt, kjo gjë ka pamundësuar në një fazë shumë të hershme çdo përpjekje për të kërkuar shërbime të tilla; dhe
- Përmendën probleme në sigurimin e produkteve kontraceptive për shkak se farmacitë në zonën e tyre u mbyllën ose nuk mund të shkonin te to për shkak të kufizimeve në lëvizje.

Personat LGBT theksuan se, pavarësisht se kanë pasur qasje të vazhdueshme në shërbimet e përgjithshme të ShSR (përveç terapisë hormonale), problem kryesor është qëndrimi dhe qasja e personelit shëndetësor që ende nuk është mësuar

të ofrojë shërbime për anëtarët e komunitetit LGBT. Kjo gjë paraqet një problem cilësor të fshehur që ka të bëjë me diskriminimin, në mënyrë specifike ndaj komunitetit LGBT.

Edhe përkundër se kanë shprehur një nivel të lartë të kënaqshmërisë për një sërë parametrash, nënat e reja përmendën gjithashtu probleme specifike që ato ose i kanë përjetuar vetë ose i kanë dëgjuar, përkatësisht:

- Mungesën në termine për kontrolle gjinekologjike për shkak të frikës se mos infektohen me Covid-19 gjatë vizitave në qendër/klinikë shëndetësore;
- Stafi i mbingarkuar me rastet e Covid-19, rrjedhimisht mungesa e respektit ndaj grave shtatzëna që kishin tashmë dy ose tre fëmijë;
- Incidentet e ofruesve të kujdesit shëndetësor (mjekët dhe infermierët), përkatësisht të qenit joprofesionistë dhe mjaft të pakujdesshëm, dhe mosofrimi i përkujdesit të nevojshëm; dhe

“Infermierët në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, e cila ndodhet në Prishtinë, janë të pakujdesshëm.

-Një nënë e re, Prishtinë

- Raportime se trajtimet e fertilitetit dhe testet e shtatzënisë nuk ofroheshin nga mjekët dhe/ose nuk kishte qasje në to për shkak të masave kufizuese të lëvizjes.

Femrat nga komunitetet e marginalizuara rome, ashkali dhe egjiptiane theksuan veçanërisht:

- Diskriminimin e vazhdueshëm që e hasin në qasjen në shërbimet e ShDSR dhe, më e rëndësishmja, gjatë konsultimeve gjinekologjike. Në shumë raste thanë që mjekët i këshillonin ato që ta vizitonin ndonjë specialist në sektorin privat dhe/ose bënë komente në bazë të gjinisë dhe origjinës etnike të pacientit. Kjo bën që ato të shmangin vizitat në shërbimin publik të përkujdesit shëndetësor. Kjo gjë ka ndodhur edhe para pandemisë, dhe duket se i ka dekurajuar përpjekjet e tyre për qasje në shërbime;
- Tabutë që lidhen me kërkimin e shërbimeve ShSR në komunitet. Gjersa kjo situatë ka qenë edhe para pandemisë Covid-19, në thelb kjo ka bërë që në shumë raste gjatë pandemisë, të kërkohet mbështetje mjekësore vetëm në raste urgjence; dhe

“Nuk kërkuam informacione sepse kujdesemi vetë për veten. Shëndeti seksual dhe riprodhues është një temë tabu në komunitetin tonë.”

“Doktori më pyeti nëse jam e martuar, sepse jam vajzë e re nga komuniteti rom.”

-Vajza të reja nga komuniteti rom

- Ndjenjën se problemet e tyre specifike shpërfillen nga mjekët:

“... cikli juaj menstrual do të përmirësohet sapo të martoheni.”

-Një vajzë e re nga komuniteti rom

Për më tepër, mungesa historike e përfshirjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në çështjet e ShDSR dhe kërkimin e shërbimeve përkatëse është evidente nga të dhënat e raportuara në vitin 2020 nga një studim i kryer nga OJQ-ja Balkan Sunflowers:

- Mbi 60% e grave në komunitet raportuan se nuk bëjnë kontrolle të rregullta te gjinekologu;
- Mbi 60% e grave pohuan se nuk kanë njohuri për shëndetin riprodhues; dhe
- 75% e grave raportuan se nuk përdornin ndonjë metodë kontrceptive.

Për vajzat që bëhen seksualisht aktive për herë të parë, qasja në shërbimet e këshillimit u përmend si një çështje e rëndësishme që është theksuar gjatë pandemisë Covid-19, duke çuar në sugjerime që autoritetet duhet t'i konsiderojnë këto shërbime si thelbësore.

“Një grup i marginalizuar në mjedisin tonë është grupi i vajzave të reja që fillojnë të jenë seksualisht aktive shumë herët dhe kanë shtatzëni të padëshiruar, për shkak të jetesës në një shoqëri tejet patriarkale”.

-Një mjek/psikiatër, klinika psikiatrike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës

Një mjek dhe një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë konfirmuan pengesat e sipërpërmendura për qasjen në shërbimet e ShSR, për shkak të vështirësive të pritshme ose mungesës së plotë të qasjes, duke raportuar se gjatë pandemisë Covid-19:

- Shërbimet e shtatzënisë nuk ishin në dispozicion për vajzat e reja sepse ishin kryesisht të mbyllura;
- Klinikat gjinekologjike nuk ishin të qasshme gjatë pandemisë dhe u kthyen kryesisht në spitale që trajtonin pacientë me Covid-19;
- Kontracesioni nuk ishte në dispozicion, duke rezultuar që pilulat kontrceptive urgjente të përdoren më shpesh sesa duhet; dhe
- Shërbimet e shëndetit mendor nuk ishin në dispozicion.

2.5 Shërbimet e ShSR rëndësia e të cilave u rrit gjatë pandemisë Covid-19

Diskutimet cilësore në fokus grupe zbuluan se një sërë shërbimesh kanë pasur rëndësi më të madhe psikologjike tek të rinjtë, veçanërisht:

- Qasja e pandërprerë tek mjekët e familjes;
- Mbështetja dhe qasja në testet e shtatzënisë dhe çështjet e shtatzënisë në përgjithësi;
- Qasja në shërbimet e konsulencës për ShSR në lidhje me mbrojtjen nga HIV dhe IST të tjera, planifikimin familjar dhe fertilitetin; dhe
- Mbështetja psikologjike dhe shërbimet e shëndetit mendor në lidhje me çështjet e ShDSR.

2.5.1 Veprimet e mundshme pozitive

Veprimet e mundshme pozitive për t'i adresuar çështjet me rëndësi më të madhe gjatë pandemisë Covid-19 përfshijnë sugjerimet e mëposhtme, e të cilat janë përmendur nga të rinjtë e anketuar në kontekstin e ndërlidhjes së kanaleve të ndryshme dhe ofrimit të informacionit, gjë që i kontribuon kërkimit të shërbimeve të ShSR:

- Forcimi dhe mbështetja e aktiviteteve të OJQ-ve- OJQ-të konsiderohen nga komuniteti LGBT dhe adoleshentët si faktor për mbështetjen e komuniteteve të mbyllura, e veçanërisht komunitetin LGBT, dhe si ofruesit kryesorë të edukimit seksual joformal përmes rritjes së financimit dhe sigurojnë funksionim të rrjedhshëm dhe të qëndrueshëm të shërbimeve ShDSR për komunitetin LGBT; dhe
- Adresimi i çështjes së dhënies së informatave të ShDSR përmes televizionit publik: gjatë pandemisë, me zvogëlimin e qasjes në informata të ShDSR, mungesën e qasjes në internet dhe njohuritë e kufizuara të shumë njerëzve në Kosovë, fakti që nevojiten informacione të besueshme dhe nga burime kredibile që nuk janë në gjuhën shqipe, e bën shumë interesant propozimin për përdorimin e televizionit publik për transmetimin e informatave të besueshme dhe kredibile.

Për më tepër, lidhur me aspektet specifike të abortit dhe ndërprerjen apo parandalimin e shtatzënisë, gjatë intervistave të detajuara mjekët i propozuan ndryshimet e mëposhtme:

- Lejimi i grave për blerjen e kontraceptivëve pa rishkruar recetën e tyre;
- Lejimi i infermiereve dhe mamive të kryejnë aborte të hershme mjekësore në shtëpitë e grave;
- Rritja e pragut të periudhës gjestacionale në të cilën mund të kryhen abortet; dhe
- Heqja e seancave të përsëritura të këshillimit ballë për ballë përpara lejimit të abortit.

2.6 Kufizimet e kanaleve: problemet në qasje në kanalet e ShSR për shkak të pandemisë Covid-19

Studimi sasior tek të rinjtë zbuloi gjithashtu një sërë ndryshimesh modelesh dhe pengesash në përdorimin e kanaleve specifike për qasje në shërbimet e ShSR gjatë pandemisë Covid-19.


2.6.1 Ndryshimet në përdorimin e kanaleve të shërbimeve tek të rinjtë

Midis të rinjve që kanë kërkuar shërbime të ShSR, vërehet një ndryshim i dukshëm në drejtim të një mbështetjeje më të madhe në:

- **Konsulta telefonike me mjekët** (21% gjatë pandemisë Covid-19, krahasuar me vetëm 10% më parë);
- **Linja telefonike** (15% gjatë pandemisë, krahasuar me vetëm 8% më parë); dhe
- **Vizita te mjekët e sektorit privat dhe jo në atë public** (42% gjatë pandemisë, krahasuar me 37% më parë).

Kanalet e përdorura për qasje në shërbimet e ShSR PARA dhe GJATË pandemisë Covid-19 - popullsia e përgjithshme rinore që ka pasur qasje në çfarëdo lloj shërbimi (% e përmendur)

■ Para pandemisë ■ Gjatë pandemisë




Burimi: Anketa sasimore e të rinjve (2021)

Të rinjtë në situata të cenueshme duket se kanë reduktuar përdorimin e shërbimeve të ShSR gjatë pandemisë, duke ruajtur qasjen vetëm tek **mjekët privatë dhe konsultimet telefonike dhe me video/**

online, me mjekët të cilët ruajnë një nivel të ngjashëm përdorimi krahasuar me periudhën para pandemisë.

Kanalet e përdorura për qasje në shërbimet e ShSR PARA dhe GJATË pandemisë Covid-19 - të rinjtë në situata të cenueshme që kanë pasur qasje në çfarëdo lloj shërbimi (% e përmendur)




Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

2.6.2 Vështirësitë në kanalet e qasjes për shërbimet ShSR gjatë pandemisë Covid-19

Matja sasiore tregon se të rinjtë në situata të cenueshme janë përballur me probleme relativisht më të mëdha për sa i përket qasjes tek mjekët privatë, konsultimet me video/online dhe ato

telefonike me një mjek, si dhe në lidhje me mundësinë e blerjes së produkteve për ShSR në internet. Këto vështirësi me shumë gjasa ndërliken me mundësitë financiare, duke sugjeruar kështu se kushtet jo të mira financiare të të rinjve të cenueshëm janë një faktor kyç që kufizon qasjen e tyre në këto shërbime.

Kanalet që janë të vështira ose të pamundura për t'iu qasur gjatë pandemisë Covid-19 (% e përmendur)



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

2.6.3 Barrierat që janë rritur për shkak të pandemisë Covid-19


Për më tepër, midis atyre që përballen me probleme specifike në qasjen në shërbimet e ShSR, është e evidente se të rinjtë në situata të cenueshme

kanë qenë më të prirur (krahasuar me të rinjtë në përgjithësi) të mendojnë se problemet janë intensifikuar për shkak të kufizimeve të udhëtimit, shqetësimeve për privatësinë dhe konfidencialitetin, mbylljen e qendrave të komunitetit lokal dhe orët e kufizuara të hapjes së qendrave shëndetësore.

Barrierat specifike që janë rritur gjatë pandemisë Covid-19 (% e përmendur)

■ Të rinjtë në situata të cenueshme

■ Popullsia e përgjithshme rinore



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

2.6.4 Cilësia e shërbimeve/produkteve krahasuar me periudhën para pandemisë Covid-19

Pavarësisht nga kanali që përdoret, gjetjet sasimore sugjerojnë se në mesin e atyre që marrin shërbime kyçe si para dhe gjatë pandemisë, cilësia kontrolleve

dhe e produkteve të higjienës menstruale nuk ka ndryshuar shumë; ekziston një tendencë më e madhe e raportimit të kontrolleve rutinore si të një cilësie më të ulët gjatë pandemisë Covid-19 se më parë; ata që kanë pasur rastin të marrin shërbime këshillimi për seksualitetin raportuan një përmirësim në cilësinë e shërbimeve.


Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve gjatë pandemisë Covid-19 në krahasim me periudhën më parë (% e përmendur)

	Më keq	Më mirë	E njëjta	Nuk mund të them
Këshillim për seksualitetin dhe/ose marrëdhëniet	17	36	25	22
Kontroll rutinore në lidhje me ShSR	31	8	38	23
Kontrolla gjinekologjike, analiza ose konsulta	26	30	33	11
Produkte të higjienës menstruale	2	7	81	10

Për më tepër, nënat e reja raportuan se janë përballur me probleme si pamundësimi i marrjes me vete të partnerit dhe të mosqenit në gjendje që

t'i planifikojnë vizitat urgjente me shpejtësi, të dyja këto për shkak të kufizimeve të Covid-19.

Përvojat negative të raportuara nga nënat e reja gjatë pandemisë Covid-19 (% e përmendur)



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

2.7 Mundësitë financiare si një dallim kyç midis "të privilegjuarve" dhe "jo të privilegjuarve"

Ka dallime në aftësinë e të rinjve për qasje në shërbimet ShDSR gjatë pandemisë Covid-19, bazuar në kontekstin e tyre social dhe ekonomik.

Nga njëra anë, popullata e përgjithshme rinore, si dhe femrat nga komuniteti serb, raportojnë (dhe ndihen të privilegjuar) se mund të kenë qasje në klinikat e kujdesit shëndetësor privat dhe mjekët në sektorin privat, kështu që nuk varen nga sistemi publik i kujdesit shëndetësor, me të gjitha të metat e tij. Nga ana tjetër, njerëzit në **zonat rurale, disa nëna të reja më pak të pasura dhe vajzat dhe gratë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian** tregoi se qasja në kujdesin shëndetësor të sektorit privat nuk është opsion për shkak të çmimit të lartë dhe mungesës së mjeteve financiare për marrjen e këtyre shërbimeve. Kjo gjë paraqet një problem të veçantë

për vajzat dhe gratë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, të cilat raportuan se ishin 'të detyruara' të kërkojnë shërbime nga sektori privat, drejtpërdrejt ose tërthorazi për shkak të sjelljes joadekuate dhe joprofesionale dhe diskriminimit të drejtpërdrejtë që hasin në sektorin publik.

"Në Kosovë e vetmja gjë që ka vlerë është paraja."
- Një nënë e re

Në këtë kontekst, vihet re se - përveç diskriminimit dhe mungesës së profesionalizmit nga ana e mjekëve- ekziston një nivel i caktuar **korupsioni**, ku pjesëmarrësit e diskutimit në fokus grupe i referohen disa rasteve të mjekëve që refuzojnë të kryejnë ekzaminime në një qendër shëndetësore publike, por në anën tjetër janë të gatshëm ta bëjnë këtë kur paguhen privatisht.

Për më tepër, një studim nga KITU dhe ADMOVERE ('Sfidat e komunitetit rom, ashkali, egjiptian në Kosovë gjatë pandemisë Covid-19') tregon se për

personat nga grupet etnike të marginalizuara, problemet janë shtuar shumë për shkak të gjendjes financiare të tyre.


Nevojat dhe shpenzimet janë rritur gjatë pandemisë, duke e bërë ndihmën sociale pothuajse të papërshtatshme për të përmbushur nevojat bazë. Për më tepër, historikisht, gjersa burrat përbëjnë shumicën të regjistruarve për të marrë ndihmë sociale (60%) në emër të familjeve të tyre, janë grate (60-65%) ato që varen më shumë nga ndihma sociale. Pamundësia e grave për qasje të drejtpërdrejt në ndihmën sociale mund ta kufizojë qasjen e tyre në nevojat bazë sanitare dhe higjienike, në varësi të mënyrës se si ndahen shpenzimet e tilla brenda familjes.

Komunitete të tilla duket se nuk janë informuar në mënyrë adekuate për Masën Nr. 15 të Pakos Fiskale Emergjente, e cila ofronte asistencë sociale prej 130 EURO në muaj për periudhën mes prillit dhe qershorit 2020 për qytetarët në kushte të rënda ekonomike, siç dëshmohet nga numri jashtëzakonisht i kufizuar i anëtarëve të këto komunitete që janë regjistruar si të papunë në qendrat e punësimit - jo më shumë se 100 deri në prill 2020.

2.8 Potenciali i teknologjisë dhe burimeve në internet për të ofruar informacione dhe shërbime të ShSR

Potenciali i teknologjisë dhe internetit për të ofruar informacione në lidhje me ShDSR duket se është mirëpritur nga ata të rinj me qasje të lehtë dhe të rregullt në përdorimin e internetit. Në këtë kontekst, të rinjtë e zonave urbane me qasje në internet raportuan se ishin të hapur për përdorimin e teknologjisë, ndërsa profesionistët shëndetësorë dhe OJQ-të gjithashtu raportuan se kishin përdorur mjete teknologjike për të ofruar informacione, konsultime, ekzaminime mjekësore dhe trajnime. Megjithatë, është e qartë se rëndësia aktuale e burimeve të tilla është kryesisht e kufizuar në fushën e situatave emergjente ose vlerësimeve fillestare.

Efektiviteti i bisedave përmes videove ose telefonit me mjekë/këshilltarë (% e përmendur)



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

Dobia afatgjatë e burimeve të tilla është kryesisht e rëndësishme në lidhje me ofrimin e informatave, në vend të ofrimit të shërbimeve, për shkak të faktorëve në vijim:

- Cilësia më e ulët e përkujdesit dhe e shërbimeve që ka të bëjë si me konsultimet online ashtu edhe me telefon (krahasuar me ekzaminimet dhe këshillimet mjekësore sy më sy), edhe tek ata të rinj me qasje në internet dhe me nivel të lartë të njohurive digjitale;
- Mungesa e lidhjeve dhe pajisjeve të internetit me cilësi të mirë në lagjet më të varfra ose zonat e largëta, duke e bërë të rrezikshme ofrimin

e këshillimit përmes telefonit, veçanërisht kur kërkohet vëmendje e shpejtë lidhur me ndonjë problem mjekësor;

- Mungesa e njohurive se si të përdoret teknologjia (ndër të rinjtë e varfër dhe pakicat e tjera etnike), duke rezultuar në mungesën e motivimit të tyre për përdorim të mjeteve të tilla për përkujdesin mjekësor; dhe
- Frika nga bullizmi kibernetik - është çështje që u përmend nga pjesëmarrësit në diskutimin e fokus grupeve si rezultat i përdorimit të internetit për t'iu qasur informatave mbi ShDSR.


III. Ndikimet emocionale dhe personale të covid-19

3.1 Ndjenjat e përgjithshme të diskriminimit dhe emocionet negative të përjetuara gjatë pandemisë Covid-19

Ndjenjat e diskriminimit të përjetuara gjatë pandemisë Covid-19 në lidhje me çështjet e ShSR në çdo nivel janë kryesisht të ngjashme midis të rinjve në përgjithësi dhe atyre në situata të cenueshme, ku ndjenjat e turpërimit dhe shkeljes së privatësisë së tyre (veçanërisht në mesin e popullatës së përgjithshme rinore) janë më të zakonshmet.

Ndjenjat e diskriminimit të përjetuara nga të rinjtë (% e përmendur)

■ Popullsia e përgjithshme rinore ■ Të rinjtë në situata të cenueshme



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)


Të rinjtë në situata të cenueshme

Të rinjtë e grupeve të marginalizuara etnike janë grupi që ka përjetuar më së shumti diskriminim për

shkak të profilit të tyre specifik, dhe për sa i përket ndjenjës së turpit dhe shkeljes së privatësisë së tyre.

Ndjenjat e diskriminimit të përjetuara - nga të rinjtë në situata të cenueshme (% e përmendur)

■ Të rinjtë e zonave urbane me status të ulët SE ■ Të rinjtë nga zonat rurale
■ Të rinjtë nga grupet e marginalizuara etnike ■ Të rinjtë e komunitetit LGBT



Burimi: Anketë sasiore e të rinjve (2021)

Megjithëse shpeshësia e deklaruar e përjetimit të ndjenjave negative nuk ndryshon në mënyrë dramatike midis të rinjve të cenueshëm dhe popullatës së përgjithshme të të rinjve, diskutimet në fokus grupe zbuluan një intensitet më të madh emocionesh midis atyre në pozita të pafavorshme. Prandaj, përderisa të rinjtë në përgjithësi nuk e raportuan situatën si një ndikim tek ata personalisht, **të rinjtë nga zonat rurale** deklaruan se ndjeheshin shumë të emocionuar për përvojat e tyre negative, dhe **të rinjtë e cenueshëm nga pakicat etnike** (përveç serbëve) raportuan diskriminime dhe paragjykime të konsiderueshme ndaj tyre nga profesionistët shëndetësor.

“Mjeku më pyeti nëse jam e martuar, sepse jam një vajzë e re nga komuniteti rom. Nuk është punë e tij se si dukem [duke iu referuar ngjyrës së lëkurës së saj që zbulon prejardhjen e saj etnike].”

-Një vajzë e re romë

Personat e komuniteti LGBT kanë përjetuar gjithashtu emocione intensive negative për shkak të Covid-19 dhe masave kufizuese si izolimi. Në një shoqëri me karakteristika të shumta patriarkale, stereotipe dhe tabu, të jesh pjesëtar i komunitetit LGBT është shumë e vështirë; veçanërisht kur vie puna të jetoni në izolim me anëtarët e familjes që ndonjëherë nuk e njohin dhe/ose nuk e pranojnë personin, individualitetin dhe identitetin e tyre gjinor, gjë që çon në **përkeqësim të stresit dhe ankthit**. Disa pjesëmarrës në studim përmendën se njerëzit duhej të largoheshin nga shtëpia e prindërve të tyre sepse situata ishte e padurueshme. Në të vërtetë, në këtë mënyrë ata përjetuan **mungesë të plotë privatësie dhe pamundësi për t'u shprehur lirisht**.

Për më tepër, shumica e anëtarëve të komunitetit mendojnë se janë përgjegjës për 'stigmën' e familjes së tyre, e cila theksohet më tej nga thashethemet në mediat sociale se homoseksualët po përhapnin virusin Covid-19. Krejt në fund, kjo duket se i ka shqetësuar personat LGBT për sa i përket mjedisit në të cilin ata janë detyruar të jetojnë ose për sa i përket nevojës për ta ndryshuar mjedisin e tyre fizik.

"Gjatë izolimit, anëtarëve të komunitetit LGBTIQ+ u është dashur të jetonin në mjedise ku ndjeheshin rehat për ta shprehur identitetin e tyre gjinor dhe seksual, ku ndonjëherë edhe ishin të rrezikuar."

"Të mos shprehesh ishte realiteti 'normal' për mua."

"Shumica prej nesh u shpërngulën për shkak të presionit që po e përjetonim në shtëpi."

"Një problem i madh për komunitetin gjatë pandemisë ishte kthimi në shtëpi tek familjet e tyre."

- Personat e komunitetit LGBT

Këto çështje që lidhen me gjendjen emocionale të të rinjve në situata të vështira u konfirmuan edhe nga profesionistët shëndetësorë. Në të vërtetë, ato janë arsyeja kryesore që na nxit të mendojmë se mjekët e familjes duhet të trajtohen më tej për çështjet e ShDSR, jo vetëm nga pikëpamja mjekësore, por edhe për sa i përket aftësisë për të treguar ndjeshmërinë dhe mirëkuptimin e duhur ndaj pacientëve.

3.2 Ndikimet negative ekonomike të pandemisë Covid-19 në kontekstin strukturor

Siç u tregua më parë, mundësitë financiare kanë qenë një faktor i rëndësishëm për sa i përket qasjes ndaj shërbimeve ShSR gjatë pandemisë për të rinjtë në situata të cenueshme. Kjo është nxitur kryesisht nga pabarazitë ekonomike nga e kaluara që janë intensifikuar më tej gjatë pandemisë Covid-19. Në të vërtetë, situata emergjente ka nxjerrë në pah problemet strukturore në shoqëri dhe dështimin e shtetit për të integruar pakicat etnike dhe për të përmirësuar standardin e tyre të jetesës.

Arsimi, punësimi, mirëqenia sociale, shëndeti dhe strehimi kanë qenë historikisht fusha në të cilat komunitetet etnike të marginalizuara kanë qenë në disavantazh të konsiderueshëm, duke i vendosur ato në rrezik më të madh të infektimit nga vetë virusi Covid-19 (KITU dhe ADMOVERE, 'Sfidat e komunitetit rom, ashkali, egjiptian në Kosovë gjatë pandemisë Covid-19').

Në vitin 2018, afërsisht 29% më shumë e familjeve romë se ato jo-romë kishin një anëtar që shkonte në shtrat i uritur, ndërsa familjet romë kishin 17% më pak gjasa të kishin banjo në shtëpitë e tyre, 10% e romëve kishin më pak gjasa për qasje në shërbimet shëndetësore parandaluese dhe të rinjtë romë kishin 23% më pak gjasa të ishin të angazhuar në punësim, arsim ose trajnim.

Reagimet nga ekspertët në fushën e ShSR-së treguan se OJQ-të, shoqatat humanitare dhe aktivistët vullnetarë ka pasur më shumë gjasa sesa institucionet qendrore që t'i trajtojnë këto probleme në menaxhimin e Covid-19. Me përjashtim të komunave të Lipjanit, Fushë Kosovës dhe Ferizajt, deklarohet se komunat në përgjithësi nuk kanë arritur t'i adresojnë nevojat e komuniteteve etnike. Kështu, ata nuk kanë marrë mbështetjen e nevojshme institucionale, dhe ndonjëherë janë përjashtuar nga ofrimi i pakove ushqimore dhe higjienike që janë shpërndarë në vend gjatë pandemisë. Në të njëjtën kohë, informatat mbi skemat e ndryshme të mbështetjes nga ana e qeverisë ishte të pamjaftueshme dhe jo të shpjeguara mirë, dhe/ose skemat nuk merrnin parasysh nevojat specifike të këtyre komuniteteve.

Mungesa e pjesëmarrjes në arsim gjatë pandemisë Covid-19 ka qenë gjithashtu një shprehje e pabarazisë ekonomike që prek komunitetet etnike. Për shkak të varfërisë dhe mungesës së pajisjeve teknologjike, anëtarët e këtyre komuniteteve në përgjithësi e kanë pasur të pamundur të vijojnë shkollën nga distanca, duke rritur më tej numrin e atyre që braktisin shkollën. Vlerësimet nga ekspertët sugjerojnë se 20–40% e studentëve nga komuniteti rom nuk janë përfshirë fare në mësimin online. Në komunën e Ferizajt, 51% e 828 nxënësve nga komunitetet etnike nuk e kanë vijuar mësimin nga distanca. Në komunën e Lipjanit, 26% nga 441 nxënës të nivelit fillor dhe të mesëm nga komunitetet etnike nuk e kanë vijuar mësimin, e kështu ishte edhe për 63% nga 30 nxënës të nivelit të mesëm të lartë.


3.3. Ndikim negativ në situatën e fëmijëve

Gjetjet e një studimi të vitit 2020 të kryer me metoda të përziera nga World Vision mbi pandeminë Covid-19 dhe fëmijët tregojnë më tej ndikimin e fortë të pandemisë për çështjet që lidhen me ShDSR dhe mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve, si më poshtë:

- **Ndikimi i Covid-19 në martesën e hershme të fëmijëve:** Si vajzat ashtu edhe djemtë raportuan se një pandemi si kjo paraqet sfida unike që mund të rrisin numrin e martesave të fëmijëve. Me rritjen e varfërisë, familjet ka më shumë gjasa të martojnë vajzat në kohë krize ekonomike për të lehtësuar barrën e perceptuar të përkujdesit për to.
- **Ndikimi i Covid-19 në punën e fëmijëve:** Sipas vajzave dhe djemve të intervistuar, pandemia ka rritur pasigurinë financiare për familjet dhe ka rezultuar në humbje të të ardhurave familjare, të cilat kanë intensifikuar pritshmëritë që vajzat dhe

djemtë të mund të kontribuojnë financiarisht për të mbështetur familjen. Mbyllja e shkollave i ka përkeqësuar këto tendenca. Në të vërtetë, 13.3% e fëmijëve të anketuar thanë se kontribuojnë në të ardhurat e familjes.

- **Dhuna ndaj fëmijëve gjatë pandemisë Covid-19** (dhuna fizike dhe emocionale në komunitet dhe rreziqet në internet): Si vajzat ashtu edhe djemtë raportuan se streset e shtuara familjare lidhur me krizën Covid-19 - duke përfshirë humbjet e vendeve të punës, izolimin, izolimin e tepruar dhe shqetësimet për shëndetin dhe financat - e kanë rritur rrezikun e dhunës fizike dhe emocionale në shtëpi. 26.1% e fëmijëve deklaruan se kanë përjetuar dhunë fizike ose emocionale.
- Vajzat dhe djemtë raportuan se kalimi i kohës në **platformat virtuale** i ekspozoi ata ndaj përmbajtjeve potencialisht të dëmshme dhe të dhunshme, si dhe ndaj **bullizmit kibernetik**. Përmbajtje të dëmshme online janë raportuar të kenë përjetuar 24% të fëmijëve në Kosovë gjatë pandemisë Covid-19




IV. Shëndeti mendor

4.1. Efekti i Covid-19 në shëndetin psikologjik dhe mendor

Siç u theksua edhe më parë, shëndeti psikologjik dhe mendor ka qenë një fushë me nevojë të veçantë për sa i përket kërkimit të informatave. Kjo duket se ndërlidhet fort me ndikimin e

konsiderueshëm negativ të pandemisë Covid-19 në shëndetin psikologjik të të rinjve në të gjithë vendin. Në veçanti, ndikimin më të madh negativ e kanë vërejtur dhe raportuar të rinjtë në situata të cenueshme, veçanërisht ata nga komunitetet etnike, personat LGBT dhe nënat e reja.

Efekti i pandemisë Covid-19 në shëndetin psikologjik dhe mendor (% e përmendur)




Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

4.2 Kërkimi i mbështetjes psikologjike dhe të shëndetit mendor gjatë pandemisë Covid-19: popullata e përgjithshme rinore

Përqindja e popullsisë së përgjithshme rinore që kërkoi mbështetje psikologjike gjatë pandemisë u rrit me 14 pikë përqindjeje (nga 38% në 52%) krahasuar me periudhën para pandemisë, megjithëse në vend të shërbimeve profesionale ka pasur një zhvendosje të dukshme kah diskutimet me familjen dhe miqtë dhe në mbështetjen e përgjithshme në internet për këtë qëllim.

Kanalet e përdorura për mbështetje/shërbime psikologjike PARA dhe GJATË pandemisë Covid-19 - popullata e përgjithshme erinore (% e përmendur)

■ Para pandemisë ■ Gjatë pandemisë




Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

Ngjashëm, tek të rinjtë në situata të cenueshme, përqindja e kërkimit të mbështetjes psikologjike gjatë pandemisë u rrit me 12 pikë përqindjeje (nga 49% në 61%) krahasuar me periudhën para pandemisë. Edhe në këtë rast, në vend të shërbimeve profesionale ka pasur një zhvendosje

të dukshme në diskutime me familjen dhe miqtë dhe në mbështetjen e përgjithshme në internet për këtë qëllim. Megjithatë, në këtë rast ka pasur edhe një mbështetje më të madhe në linjat telefonike në krahasim me periudhën para pandemisë.

Kanalet e përdorura për qasje në mbështetjen/shërbimet psikologjike PARA dhe GJATË pandemisë Covid-19 - të rinjtë në situata të cenueshme (% e përmendur)

■ Para pandemisë ■ Gjatë pandemisë




Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

4.3. Barrierat për qasje në shërbime mbështetëse të shëndetit psikologjik dhe mendor

Të gjithë të rinjtë përmendën se përballen me probleme lidhur me qasjen në shërbimet mbështetëse të shëndetit mendor përmes takimeve direkte dhe në shkollë. Është gjithashtu evidente se të rinjtë në situata të cenueshme janë përballur me një gamë dukshëm më të gjerë problemesh në drejtim të kanaleve të ndryshme, veçanërisht në lidhje me marrjen e mbështetjes nga OJQ-të ose grupet e tjera mbështetëse të të rinjve.

Kanalet që janë të vështira ose të pamundura për t'u qasur gjatë pandemisë Covid-19 (% e përmendur)



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

4.4. Mangësitë institucionale në ofrimin e mbështetjes për shëndetin mendor gjatë pandemisë Covid-19

Shërbimet e shëndetit mendor në Kosovë ofrohen në dy nivele nga tetë qendra komunitare të shëndetit mendor dhe repartet psikiatrike brenda spitaleve të përgjithshme. Shërbime të tjera të shëndetit mendor ofrohen nga psikiatër dhe psikologë që punojnë privatisht. Në nivelin terciar, shërbimet e shëndetit mendor ofrohen nga Klinika e Psikiatrisë, Instituti i Psikiatrisë Ligjore, dhe në Qendrën e Shëndetit Mendor të Fëmijëve dhe Adoleshentëve.

Megjithatë, një numër mangësish ekzistuese, si para ashtu edhe gjatë pandemisë Covid-19, u identifikuan përmes hulumtimit të dokumentacionit. Përveç në kryeqytetin e Prishtinës, shërbimet për shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve janë të pazhvilluara. Në sfidat që paraqiten në kontekstin kosovar gjatë pandemisë Covid-19 lidhur me shërbimet e shëndetit mendor, sipas Sousa dhe kolegëve (2020), përfshihen:

- Mungesa e burimeve;
- Adresimi i nevojave të popullatave të veçanta si fëmijët;

adresimi i problemeve të ndryshme psikosociale si problemet financiare si pasojë e pandemisë;

- Problemet me stigmatizimin e shëndetit mendor në përgjithësi dhe problemet e shëndetit mendor;
- Mungesa e një shërbimi të telepsikiatrit; dhe
- Mungesa e një plani emergjent të gatishmërisë për shërbimet e shëndetit mendor.

4.5. Barrierat e perceptuara dhe strukturore për të rinjtë që kërkojnë mbështetje efektive për shëndetin mendor

Diskutimet cilësore në fokus grupe me të rinjtë dhe intervistat e detajuara me ekspertë zbuluan më tej një sërë çështjesh që ndikojnë efektivisht si në motivimin ashtu edhe në aftësinë për qasje në mbështetje efektive të shëndetit mendor nga profesionistët.

Mbi të gjitha, çështja e mbështetjes psikologjike në Kosovë është tabu; njerëzit që marrin mbështetje ose këshillim psikologjik stigmatizohen:

"Nëse shkoni te psikologu, ju konsiderojnë të çmendur."

-Një i ri, Prishtinë

Konfuzioni në lidhje me dallimin midis një psikologu dhe një psikiatri çon në pasiguri në caktimin e konsultave me profesionistë. Më konkretisht, të rinjtë në zonat urbane po e kuptojnë nevojën për mbështetje psikologjike; megjithatë, për shkak të kufizimeve kulturore, kërkimi i shërbimeve për këshillim psikologjik nga spitalet publike apo edhe pyetja e të tjerëve për këtë gjë është problematike, për shkak të stigmatizimit. Në anën tjetër, është më e lehtë të kërkohen konsultime online, për shkak të anonimitetit të shërbimit. Të rinjtë nga zonat rurale gjithashtu iu referuan kanaleve online si mënyrë kyçe për të mbetur anonim.

Vajzat dhe gratë rome, ashkali dhe egjiptiane raportuan mungesën e njohurive se si të kërkohej mbështetje profesionale, megjithëse u përmend pozitivisht një OJQ që ofronte konsultime psikologjike.

Personat nga komuniteti LGBT kanë më së shumti njohuri me çështjet e shëndetit mendor dhe nevojën për mbështetje profesionale psikologjike, për shkak të nevojës së tyre në rritje për të shmangur diskutimet brenda rrethit të tyre familjar. Në këtë kontekst, anëtarët e komunitetit LGBT deklaruan

gjithashtu një preferencë të fortë për ndihmë nga një OJQ që po ofronte mbështetje psikologjike specifike për personat LGBT.

4.6. Reagime positive që sugjerohen për ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor

Nisur nga ky kontekst, profesionistët konfirmuan rritjen e kërkesës së përgjithshme për shërbime të shëndetit mendor, por në të njëjtën kohë një **paaftësi për të ofruar një përgjigje adekuate kolektive**. Zgjidhja kryesore e sugjeruar nga profesionistët ishte aftësia për të dhënë informata shpejtë dhe me saktësi. Duke pasur parasysh konfuzionin dhe gjendjen e panikut mes popullatës gjatë pandemisë Covid-19, u theksua rëndësia e një burimi kryesor informacioni dhe e shërbimeve nga ekspertët e shëndetit mendor:

"Dy elementet kryesore me të cilat përballemi në këtë situatë janë urgjenca dhe saktësia e informacionit: një 'psikiatri e adoleshentëve' ku mund të gjesh psikologë, psikiatër dhe punonjës socialë.

-Një mjek/psikiatër, klinikë psikiatrike

Për më tepër, siç thuhet nga profesionistët në një studim ('Ndërtimi i Shërbimeve të Ndhmës së Parë Psikologjike Online dhe Telefonike në një mjedis me burime të kufizuara gjatë Covid-19: Rasti i Kosovës', Psychiatria Danubina, dhjetor 2020), sugjerimet janë diskutuar në nivel lokal për sa i përket:

- Krijimit të shërbimeve të ndihmës së parë psikologjike online dhe telefonike (në një nivel fillestar);
- Zhvillimin e **videove psiko-edukative dhe webinarëve** (të cilat janë prezantuar, por me sa duket nuk kanë arritur një pjesë të konsiderueshme të audiencës rinore);
- **Promovimi i këtyre shërbimeve si fokus qendror i aktivitetit;** dhe
- **Kurrikula akademike** për trajnimin e profesionistëve të shëndetit mendor për të integruar kurse që lidhen me shëndetin mendor digjital dhe udhëzime se si të krijohen këto lloj shërbimesh gjatë krizave.


V. Dhuna seksuale dhe dhuna me bazë gjinore

Bashkë me fushën e shëndetit mendor, dhe në shumë raste e ndërlidhur me të, çështja e dhunës seksuale dhe dhunën me bazë gjinore përbën një fushë kyçe në lidhje me ShDSR, e cila shtrihet tek audienca të ndryshme të të rinjve.

5.1 Incidenca e dhunës seksuale dhe me bazë gjinore

Më shumë se një në pesë të rinj në Kosovë kanë pohuar se kanë përjetuar ose kanë qenë dëshmitarë të një incidenti të dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore gjatë pandemisë Covid-19. Kjo incidencë është veçanërisht e lartë në mesin e atyre nga komunitetet etnike të marginalizuara si romë, ashkali apo egjiptianë.

Përqindja e të rinjve që kanë përjetuar personalisht ose që kanë qenë dëshmitar të incidenteve të dhunës seksuale dhe me bazë gjinore gjatë pandemisë Covid-19 (% e përmendur)



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

Studimi i kryer nga OJQ-të KITU dhe ADMOVEERE (2020) mbi sfidat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë gjatë pandemisë Covid-19 tregojnë një rritje të konsiderueshme nga viti në

vit të raportimit të rasteve të dhunës në familje në komunitete, si në vijim:

Muaji	Numri i rasteve të raportuara të dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore
Mars 2019	124
Mars 2020	169
Prill 2019	138
Prill 2020	167
Maj 2019	141
Maj 2020	174

5.1.1 Vlerësimi i reagimit të shtetit ndaj dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore gjatë pandemisë Covid-19

Në këtë situatë të rritjes së incidencës së dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore gjatë pandemisë Covid-19, një pjesë e konsiderueshme e të rinjve deklaruan se shteti nuk e ka trajtuar në mënyrë adekuate këtë çështje (59% e popullsisë së përgjithshme rinore dhe 48% e të rinjve në situata të cenueshme).

Shteti nuk e ka trajtuar në mënyrë adekuate dhunën seksuale dhe me bazë gjinore gjatë pandemisë Covid-19 (% e përmendur)



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)


5.2 Kërkimi i mbrojtjes efektive në rastet e dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore

Pavarësisht rritjes së incidencës së dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore gjatë pandemisë, 44% e atyre që hasën në incidente të tilla ose nuk dinin të kërkonin mbështetje ose nuk ndërmorën asnjë veprim, duke vënë në pah kështu një sërë

pengesash themelore në këtë drejtim. Në veçanti, kërkimi i mbështetjes nga këshilltarët, kërkimi i ndihmës nëpërmjet aplikacioneve celulare dhe tek OJQ-të kanë qenë burime të rëndësishme që janë kërkuar, duke lënë në hije gatishmërinë për t'iu drejtuar institucioneve mbrojtëse si policia apo strehimoret. Është e qartë se – në shumëllojshmërinë e burimeve të kërkuara – ka munguar dukshëm mbështetja e përgjithshme.

Mbështetja e kërkuar dhe e marrë në rastet e dhunës seksuale dhe me bazë gjinore gjatë pandemisë Covid-19 (% e përmendur)

- Mbështetja e marrë pas dëshmimit ose përjetimit të incidentit
- Veprimet e ndërmarra pas dëshmimit ose përjetimit të incidentit



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

5.3 Barrierat për kërkimin dhe marrjen e mbrojtjes efektive në rastet e dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore

Një gamë e gjerë studimesh të kryera në lidhje me dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore tregojnë një sërë pengesash drejt kërkimit dhe qasjes në mbështetje efektive.

Sipas studimit 'Trajtimi i COVID-19 nga perspektiva gjinore: Rekomandime për Qeverinë e Kosovës' (https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/04/Addressing-COVID-19-from-a-Gender-Perspective_04_04_2020.pdf), rrethanat e pandemisë e kanë bërë edhe më të vështirë për viktimat raportimin e incidenteve të dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore, pasi viktimat kanë qëndruar të mbyllura me dhunuesit e tyre. Kjo ka bërë që të rritet stigma ekzistuese rreth dhunës në familje duke kontribuar në zvogëlim të raportimit të rasteve.

Edhe pse strehimoret në Kosovë (të drejtuara nga OJQ-të) që ofrojnë mbështetje për njerëzit që vuajnë nga dhuna raportuan se po e menaxhojnë mirë ngarkesën shtesë të punës, **mungesa e ofrimit të trajtimit adekuat psikologjik për viktimat e dhunës në familje për shkak të masave të izolimit, shoqëruar me frikën e punonjësve social nga rreziku i infektimit**, mund të ndikojnë në aftësinë e tyre për të ofruar shërbime efektive. Prandaj, **ndërgjegjësimi për modele të tilla mund të jetë i dobishëm për përqindjen relativisht të ulët të njerëzve që kërkojnë mbështetje nga strehimoret.**

Në kontekstin e një shoqërie patriarkale, gratë vazhdojnë të shihen si **fajtores dhe jo si viktime**, veçanërisht në raportimin e rasteve të përdhunimit ose dhunës. Besimi se **autoritetet po e mbajnë gjallë këtë model** në mënyrë të pashmangshme çon në dekurajim nga kërkimi i mbështetjes nga autoritetet zyrtare ose raportimi i incidenteve.

Ekziston në përgjithësi një pajtueshmëri që dështimi i institucioneve qeveritare për të mbrojtur dhe mbështetur të mbijetuarit e dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore është edhe **më i madh në rastin e grupeve të marginalizuara**, siç janë anëtarët e komunitetit LGBT, gratë e reja të cënueshme dhe gratë nga pakicat etnike. Ky fenomen çon në humbjen e besimit të institucioneve – siç u theksua gjatë pandemisë – gjë që zvogëlon motivimin për t'i raportuar incidentet. Ekzistojnë perceptime të forta, veçanërisht në zonat rurale, midis personave LGBT dhe grave të reja në komunitetin serb se burimet publike të mbrojtjes janë krejtësisht të pamjaftueshme, duke pamundësuar kështu aftësinë e vajzave dhe grave të reja për të kërkuar dhe për të marrë mbrojtje të duhur:

"Në departamentin e policisë ka shumë neglizhencë."

-Një e re në një zonë të largët

"Prokuroria është neglizhuesi më i madh. Shërbimet e mbështetjes publike nuk ofrojnë mbështetje dhe siguri për komunitetin LGBTIQ+."

- Personi nga komuniteti LGBT

"Por çfarë ndodh më pas [pasi ta raportoni rastin]?"

-Një grua e re nga komuniteti serb

Institucionet qeveritare gjithashtu i neglizhojnë rastet që përfshijnë anëtarë të komunitetit LGBT ose i pengojnë OJQ-të që mbështesin të drejtat LGBT, duke rezultuar në **mungesë motivimi për të raportuar incidente të dhunës ndaj personave LGBT:**

"Institucionet publike i neglizhojnë rastet LGBTIQ+. Duke u nisur nga policia, prokurori merr një vendim të menjëhershëm, gjë që i bën njerëzit e komunitetit të hezitojnë që t'i denoncojnë rastet e tyre. Megjithatë, kur keni përfaqësues ligjor kur raportoni kërcënime, ata ju marrin më seriozisht. Përfaqësuesi i OJQ-së u përball me rreth 500 kërcënime në 6 vite të tranzicionit të një personi."

- Person nga komuniteti LGBT

Çështjet e lartpërmendura u konfirmuan nga ekspertët gjatë intervistave të detajuara. Ekspertët gjithashtu arritën në përfundim se dhuna seksuale dhe dhuna me bazë gjinore raportohet pak dhe se në shumicën e rasteve ajo pranohet nga viktimat – një model që daton qysh para pandemisë:

“68% e grave kanë përjetuar dhunë seksuale dhe dhunë me bazë gjinore, por vetëm 2% e kanë raportuar atë.”

- Ekspert nga OJQ-të

Ata pranojnë se të rinjtë nuk e kanë **vetëbesimin për të paraqitur dhe raportuar incidente dhune**, duke preferuar ta mbajnë atë brenda vetes pa i ditur pasojat. Megjithatë, të rinjtë dhe të rejtat nuk dinë as ku t'i raportojnë problemet që lidhen me dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore. Ekspertët përmendën mungesën e fokusit në drejtim të të mësuarit të rëndësisë së dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore (dhe në të vërtetë si ta njohim këtë si të tillë) në shkolla. Ata besojnë se vetëm dhunës në familje i është kushtuar vëmendja, duke neglizhuar rastet e bullizmit kibernetik që veçanërisht janë prezente tek të rinjtë. Ekspertët theksuan gjithashtu rrezikun e shtuar për të rinjtë nga komunitetet e pakicave etnike dhe fëmijët.

5.4 Reagime dhe sugjerime pozitive në lidhje me dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore

Pavarësisht mangësive të institucioneve publike, një sërë përgjigjesh pozitive u theksuan në lidhje me dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore gjatë pandemisë Covid-19. Për shembull, OJQ-të raportuan një sërë veprimesh të ndërmarra me iniciativën e tyre për t'i mbështetur fizikisht gratë viktimat dhe për të ndërhyrë në rastet e tyre duke ofruar mbështetje ligjore dhe financiare.

“Organizata ishte e fokusuar kryesisht që t'u ofronte ndihmë strehimoreve në të cilat ishin strehuar gratë që ishin viktimat të abuzimit seksual, sigurimin e ushqimit dhe veshjeve dhe përgatitjen për izolim të rreptë...”

“...Organizata bashkëpunoi me Ministrinë e Drejtësisë që gratë e strehuara të kenë mundësi punësimi...”

“...Organizata ofroi asistencë ligjore në gjykata për gratë që ishin viktimat të dhunës në internet.”

- Ekspert nga OJQ-të

Një studim nga organizata UN Women për Europë dhe Azi Qendrore (me OJQ që ofrojnë shërbime)

zbuloi se ka të paktën pesë OJQ në Kosovë që punojnë në veçanti në fushën e dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore dhe ofrojnë mbështetje psikologjike, si dhe shtëpi të sigurta për viktimat. Studimi identifikoi këto pesë OJQ si mesatarisht fleksibile ndaj krizës, pasi ato i kanë mjetet financiare për të ruajtur nivelin aktual të operimit deri në 6 muaj. Prandaj bëhet thirrje për financim të mëtejshëm të OJQ-ve të tilla në këtë drejtim.

Përveç ofrimit të shërbimeve për gratë viktimat të dhunës, OJQ-të kanë bërë fushata, aktivitete ndërgjegjësimi dhe avokimi gjatë pandemisë Covid-19. Fokusi ka qenë në:

- Krijimin e mekanizmave funksional të koordinimit;
- Media dhe raportimin për dhunën ndaj grave;
- Martesat e hershme në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë;
- Përshtatjen e shërbimeve në mbështetje të viktimave të dhunës ndaj grave në përputhje me Konventën e Stambollit; dhe
- Reagime më efektive institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore.

“Gjatë pandemisë, përmes dy fushatave sensibilizuese për martesat e hershme dhe diskriminimin gjinor, ne kemi kontaktuar me 270 familje rom, ashkali dhe egjiptiane, kryesisht ato me vajza të reja në rrezik për të braktisur shkollën dhe të prirura për martesë të hershme. Ne kemi punuar gjithashtu me policinë, avokatët e të mbijetuarave, punonjësit socialë, strehimoret dhe avokatin e popullit për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me rastet e dhunës ndaj grave.”

-Drejtori ekzekutiv i rrjetit me fokus në komunitetet etnike

VI. Vlerësimi i reagimit institucional ndaj Covid-19 në lidhje me shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese

6.1 Reagimi joadekuat nga sistemi shëndetësor dhe qeveria

Provat janë dërrmuese se të rinjtë besojnë fuqishëm se pandemia Covid-19 ka shpërfaqur edhe më tej rëndësinë e kufizuar që i kushtohet çështjeve të

ShDSR nga autoritetet në Kosovë. 55% e popullatës së përgjithshme rinore si dhe 40% e atyre në situata të cenueshme e kanë këtë perceptim. Ky qëndrim është i përhapur sidomos te të rinjtë me status të ulët socio-ekonomik në mjediset urbane (50%) dhe ata nga komunitetet etnike të marginalizuara (46%).

Pandemia Covid-19 ka treguar se sa pak vëmendje i është kushtuar ShDSR nga autoritetet shtetërore (% e përmendur)



Burimi: Anketa sasiore e të rinjve (2021)

Diskutimet në fokus grupe shpërfaqën gjithashtu një perceptim të ngjashëm, ku kishte pajtim të përgjithshëm se reagimi i qeverisë dhe autoriteteve ndaj pandemisë Covid-19 ka qenë tërësisht jorelevant në lidhje me shërbimet ShDSR, dhe nuk kishte asnjë referencë për ndonjë veprim pozitiv të ndërmarrë në këtë drejtim. Në anën tjetër, të vetmet veprime në nivel institucional që u konsideruan si pozitive ishin ato të ndërmarra nga OJQ-të:

“Çdo informatë mbi ShDSR gjatë Covid-19 erdhi nga OJQ-të.”

- Person nga komuniteti LGBT

Aktivitetet e organizuara nga OJQ-të përfshinë ofrimin sesioneve për nënat, duke u ofruar atyre këshilla të besueshme gjatë shtatzënisë dhe lidhur me kujdesin për foshnjën e porsalindur, këshilla për ushqyerjen me gji dhe ushqyerjen e foshnjës. OJQ-të shpërndanë gjithashtu produkte menstruale falas, prezervativë falas, teste për HIV-in dhe teste për hepatitin B dhe C, si dhe ofruan shërbime ligjore dhe psikologjike.

Komentet nga ekspertët konfirmuan më tej se ekziston një dakordim kolektiv se pandemia ka vepruar si një thirrje për zgjim për sa i përket trajtimit të çështjeve shëndetësore të të rinjve, por i ka zënë institucionet në befasi. Është gjithashtu evidente se profesionistët shëndetësorë presin që Ministria e Shëndetësisë të jetë në krye të dhënies së informacionit për ShDSR.

6.2 Kufizimet sistematike, legjislative dhe politike

Përveç mungesës së plotë të besimit në institucionet e sektorit publik, është evidente se (i) situata politike në Kosovë; (ii) fakti që vendi është shumë i varur nga mbështetja e jashtme, si në aspektin financiar ashtu edhe në atë organizativ; dhe (iii) mungesa e kohezionit brenda një shoqërie multikulturore, të gjitha këto paraqesin sfida të veçanta për trajtimin e duhur të çështjeve të ShDSR në përgjithësi dhe gjatë kohërave të krizave.

Në këtë kontekst, ekspertët iu referuan mungesës së vullnetit politik kolektiv nga e gjithë shoqëria e organizuar, politikanët, grupet e organizuara të akterëve të ndryshëm (sektori privat, tregtia, sipërmarrjet, sindikatat, OJQ-të) në drejtim të ndryshimeve thelbësore në fushën e ShDSR.

Ministria e Shëndetësisë raportoi se rishikimi i ligjeve për ShDSR dhe abortin duhet të jetë prioritet i shtetit, e gjithashtu edhe ofrimi i edukimit seksual në shkolla qysh në moshë të hershme. Një tjetër qëndrim i fuqishëm që u shpreh ishte se ka

mungesë të vëmendjes ndaj çështjeve të ShDSR nga edukatorët në shkolla dhe se ka mungesë të të dhënave në lidhje me ShDSR në përgjithësi:

“Ne nuk kemi të dhëna konkrete për ShDSR... Jemi të kufizuar për nga legjislacioni.”

-Një Zyrtar i Ministrisë së Shëndetësisë

Për më tepër, siç u tha nga një ekspert i shëndetit riprodhues, shpërndarja e informacionit për ShDSR duket se bazohet kryesisht në informacione dhe udhëzues të përgjithshëm ndërkombëtar, në vend që të përshtatet për të rinjtë kosovarë:

“Ne nuk po i trajtojmë gjërat në mënyrë specifike [d.m.th. nuk po merremi me ShDSR në detaje], përveç krijimit të disa udhëzuesve [të përgjithshëm]. U kemi shpërndarë njerëzve shumë informacione që kemi marrë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, me qëllim që të mos krijojmë konfuzion në ofrimin e informacionit nga akterë apo institucione të ndryshme. Nuk kemi krijuar asgjë sepse të gjithë kemi qenë të fokusuar në hartimin e masave mbrojtëse për Covid-19.”

- Një ekspert i shëndetit riprodhues



VII. Praktikak pozitive

Pavarësisht mangësive për sa i përket reagimeve pozitive ndaj pandemisë Covid-19, një sërë praktikash pozitive u identifikuan se janë zbatuar gjatë pandemisë, qoftë si vazhdimësi e aktiviteteve të zhvilluara më parë, qoftë si përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj krizës.

Gjersa shumë nga këto praktika mund të mos kenë pasur një ndikim të fortë drejt arritjes së qëllimeve të tyre, zbatimi ose zgjerimi i mëtejshëm i tyre mund të japë rezultate premtuese. Për më tepër, ato përfshijnë gjithashtu një sërë reagimesh më të përgjithshme që ka mundësi për t'u transferuar në fushën e shpërndarjes së informacionit mbi ShDSR dhe ofrimin e shërbimeve përkatëse.

7.1 Edukimi seksual dhe informimi

Praktikat

Veprimet/ objektivat e mëtejshme

Mbështetja edukative lidhur me ShSR për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian gjatë pandemisë Covid-19, ofruar nga Balkan Sunflowers (OJQ me bazë vullnetare) në një projekt të mbështetur nga UNFPA:

- themelimi i pesë klubeve rinore me qendra mësimore, duke i lejuar të rinjtë t'i adresojnë çështjet që lidhen me ShSR, si dhe problemet e përgjithshme shëndetësore të shkaktuara nga pandemia;
- anketa e administruar nga pesë koordinatorë të qendrave mësimore, duke u fokusuar në problemet shëndetësore (numri i grave shtatzëna, kujdesi para lindjes, IST, kanceri i qafës së mitrës, kanceri i gjirit, Covid-19, planifikimi familjar, HIV, personat me diabet, personat me aftësi të kufizuara, personat me probleme të frymëmarrjes, hipertension, dhe me probleme kardiovaskulare);
- Angazhimi dhe fuqizimi i së paku 20 të rinjve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në aktivitete që kanë të bëjnë me shëndetin, përmes një trajnimi treditor lidhur me ShSR dhe informimi mbi politikat shëndetësore dhe mekanizmat shëndetësorë;
- vizita në shtëpi tek rreth 1500 familje, për të rritur ndërgjegjësimin për IST dhe Covid-19; dhe
- vizita personale tek gratë shtatzëna, për të rritur ndërgjegjësimin e tyre lidhur me shtatzëninë e shëndetshme, planifikimin familjar, IST-të, mbrojtjen nga Covid-19 dhe mirëqenien e foshnjës.

Është raportuar intenzivisht nga OJQ-të, por ndërgjegjësimi mbetet i kufizuar në mesin e të rinjve të intervistuar

Rritja e ndërgjegjësimit për ekzistencën e klubeve të tilla rinore me fokus në të mësuarit lidhur me çështjet e ShDSR.

Rritja e numrit të klubeve të tilla rinore nëpër komunitete.

Ndërmarrja e iniciativave të tilla në grupet etnike të marginalizuara dhe komunitetin LGBT.

Fondacioni i Kosovës për Popullsinë (KOPF), i mbështetur nga UNFPA, ka realizuar trajnim virtual për ShDSR me të rinjtë nga komuna e Dragashit.

Trajnimi përfshinte një modul mbi pandeminë Covid-19 bazuar në materialet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe 22 të rinj patën mundësinë t'i ndiqnin këto sesione trajnimi nga shtëpitë e tyre, duke rritur kështu njohuritë e tyre mbi ShDSR dhe duke mbrojtur veten dhe familjet e tyre nga infektimi i mundshëm me Covid-19.

Identifikuar përmes hulumtimit të dokumentacionit

Përdorimi i materialeve ndërkombëtare si ato të hartuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, por mundësisht të bëhen përshtatje në përputhje me kontekstin e të rinjve në Kosovë.

7.2 Sigurimi i informatave të besueshme dhe ofrimi i shërbimeve

Praktikat

Veprimet/ objektivat e mëtejshme

<p>Komuna e Fushë Kosovës ka themeluar një nën-shtab emergjent për komunitete, në krye me nënkryetarin për komunitete, për t'u marrë me çështjet që kanë të bëjnë me ShDSR.</p> <p>Identifikuar përmes hulumtimit të dokumentacionit</p>	<p>Kjo u konsiderua si një praktikë shumë e mirë dhe duhet të merret parasysh dhe ndoshta të zbatohet edhe nga komunitetet e tjera.</p> <p>Përfshirja e autoriteteve komunale si autoritet publik me qasje më të madhe tek komunitetet lokale për ofrimin e informatave praktike.</p>
<p>Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës (RROGRAEK) ka organizuar dy fushata sensibilizuese për martesat e hershme dhe diskriminimin gjinor, duke arritur tek 270 familje rome, ashkali dhe egjiptiane, kryesisht ato me vajza të reja në rrezik të braktisjes së shkollës dhe të prirura për martesat e hershme.</p> <p>Raportuar nga RROGRAEK dhe shënjestrimi i çështjeve që nga këto komunitete janë konsideruar si shumë të rëndësishme për ta</p>	<p>Një shembull i shkëlqyer i komunikimit të shënjestruar. Aktivitete të tilla duhet të mbahen edhe pas pandemisë Covid-19.</p> <p>Qasje të ngjashme sy më sy mund të jenë të dobishme për të rinjtë tjerë lidhur me fusha të tjera si kontracesioni, praktikimi i seksit të sigurt dhe këshillimi familjar.</p>
<p>Gratë shtatzëna konsiderohen si grup me prioritet në institucionet shëndetësore publike.</p> <p>Theksuar nga nënat e reja dhe nga akterët ekspertë</p>	<p>Prioritizimi i çështjeve të ShDSR me shumë gjasa do të pritet mirë nga të rinjtë e interesuar.</p> <p>Krijimi i një game më të gjerë shërbimesh themelore të ShSR në praktikë dhe (nëse është e mundur) në legjislacion ka gjithashtu të ngjarë të parandalojë mungesën e fokusit në to në situatat e ardhshme të krizave.</p>
<p>Mbështetja e vazhdueshme e ofruar nga OJQ-të për komunitetin LGBT.</p> <p>Theksuar nga personat LGBT si burimi i vetëm i besueshëm i mbështetjes gjatë pandemisë Covid-19</p>	<p>OJQ-të kanë dëshmuar vlerën e tyre gjatë krizës dhe duhet të mbështeten më tej financiarisht dhe duke u dhënë një rol më të madh në politikëbërje.</p>

7.3 Shëndeti mendor

Praktikat

Ministria e Shëndetësisë krijoi një linjë telefonike falas që ofron mbështetje psikosociale gjatë pandemisë.

Raportuar nga Ministria e Shëndetësisë; ka pasur një rritje për sa i përket kërkesës për shërbime telefonike dhe të linjës telefonike nga të rinjtë gjatë pandemisë, megjithëse nuk është veçuar shumë si e specializuar në çështjet e shëndetit mendor

Organizata QIPS krijoi një linjë telefonike për parandalimin e vetëvrasjeve.

Identifikuar përmes hulumtimit të dokumentacionit

Veprimet/ objektivat e mëtejshme

Nevojitet komunikim më i madh për një linjë të tillë telefonike, duke përfshirë komunikim të qartë në një mënyrë që destigmatizon kërkimin e mbështetjes psikologjike.

Të krijohet një kanal telefonik afatgjatë që i kushtohet parandalimit të vetëvrasjeve.

7.4 Dhuna seksuale dhe dhuna me bazë gjinore

Praktikat

Veprimet/ objektivat e mëtejshme

OJQ-të rritën kapacitetin e pranimit të grave të mbijetuara të dhunës në familje (më shumë se 500) me mbështetjen e UN Women në kuadër të programit rajonal për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor.

Identifikuar përmes hulumtimit të dokumentacionit

Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit për skemën.

Ofrimi i mbështetjes financiare për OJQ-të për të zgjatur periudhën e 'mbijetesës' së tyre përtej 6 muajsh në kohë nevojash më të mëdha.

UNFPA po trajton dhunën me bazë gjinore në rajonin e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore, duke përfshirë edhe Kosovën, duke:

- mbështetur strategjitë kombëtare në parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe rritjen e ndërgjegjësimit nëpërmjet zhvillimit të produkteve dhe aktiviteteve në rrjete sociale bazuar në nevojat e refugjatëve/migrantëve;
- duke siguruar vazhdimësinë dhe qasjen në shërbime multi sektoriale për dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave adoleshente. Kjo përfshin mbështetjen mjekësore, këshillimin psikosocial, linjat telefonike mbështetëse, hapësirat e sigurta për të mbijetuarit e dhunës, menaxhimin e rasteve dhe referimet;
- përmirësuar kapacitetet dhe aftësitë e ofruesve të shërbimeve të linjës së parë, veçanërisht për punonjësit shëndetësorë dhe psikosocialë dhe policinë, duke synuar kështu forcimin e reagimit të koordinuar multisektorial ndaj dhunës me bazë gjinore në kontekstin e Covid-19; dhe
- duke përshtatur një udhëzues për zhvillimin e shërbimeve thelbësore në distance për dhunën me bazë gjinore, duke marrë parasysh masat e distancimit social dhe kufizimin e lëvizjes. Udhëzuesi përfshin nevojat specifike të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe të të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore, duke u fokusuar veçanërisht në shërbimet e mbështetjes psikosociale dhe referimin e tyre në kontekstin e krizës Covid-19.

Identifikuar përmes hulumtimit të dokumentacionit dhe raportuar nga ekspertët

Skema gjithëpërfshirëse e mbështetjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore

Mekanizmat e referimit për viktimat mund të kenë prioritet edhe pas pandemisë, duke e kthyer udhëzimin në praktikë.

UN Women në Kosovë së fundi ka mbështetur krijimin e një databaze kombëtare për dhunën në familje. Aty dokumentohen rastet e dhunës në familje dhe lejohet qasja në informata për policinë, shërbimet sociale dhe firmat ligjore për t'i sjellë autorët e krimit para drejtësisë. Databaza përfshinë një sistem gjurmimi për gjurmimin e rasteve të abuzimit.

Identifikuar përmes hulumtimit sekondar

Të sigurohet përditësimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave.

Mund të shtohet edhe një dimension monitorimi për të vëzhguar se si agjencitë mbrojtëse dhe policia zgjidhin rastet e raportuara të dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore.

Praktikat

Veprimet/ objektivat e mëtejshme

Një fushatë publike me video të shkurtra nga liderë me ndikim në Kosovë i është bashkangjitur fushatës së UN Women 'Raporto dhunën, shpëto jetë!' kundër dhunës në familje.

Kryeministri dhe kryetarja e parë grua e Kuvendit iu bashkuan fushatës, ashtu si edhe ministra të tjerë, politikanë dhe të mbijetuar të dhunës në familje.

Fushata u shtri tek 200,000 njerëz në rrjete sociale brenda 2 ditëve, dhe mbi një milion individë brenda pak javësh (Ilogaria e UN Women Kosovo në Facebook)

Fushatat në rrjete sociale mund të jenë veçanërisht të dobishme për të arritur audiencën e të rinjve dhe mund të shtrihen në fusha të tjera të ShSR.

Përfshirja e figurave politike dhe publike në baza të vazhdueshme dhe në të gjithë gamën e çështjeve të ShSR mund të çojë në njëfarë mënyre drejt tejkalimit të mosbesimit të publikut në institucione.

Përpjekjet e bëra nga OJQ-të për të kërkuar fonde emergjente për të blerë pajisje higjienike për strehimore.

Raportuar nga një OJQ

Mbështetja financiare emergjente është shumë e nevojshme në kohë krize.

Duhet siguruar një rrjedhë më të përhershme të burimeve financiare, për të shmangur nevojën për fonde emergjente në 'minutat e fundit'.

Bashkëpunimi i drejtpërdrejtë i OJQ-ve me UN Women për sigurimin e pajisjeve teknologjike si telefonat, për të vazhduar me mbështetjen e këshillimit për gratë e mbijetuara të dhunës seksuale dhe me dhuna bazë gjinore.

Raportuar nga një OJQ

Duhet të pranohet fakti se gratë që janë viktime shpesh janë pjesë e grupeve më të cenuara financiarisht të popullsisë.

Investimi në teknologji dhe shkrim-lexim në mesin e grupeve të cenueshme duhet të përcaktohet si synim afatgjatë i politikëbërjes.

Bashkëpunimi i OJQ-ve me Ministrinë e Drejtësisë për të mundësuar punësimin e grave në strehimore arrihet ligjërisht dhe praktikisht.

Raportuar nga një OJQ

Një mjet i fuqishëm fuqizimi dhe përfshirjeje që mund ta bëjë opsionin e kërkimit të mbrojtjes në strehimore më tërheqës për gratë.

7.5 Ofrimi i produkteve


Praktikat

OJQ-të ofruan teste falas për HIV dhe IST për komunitetin LGBT.

Theksuar nga personat e komunitetit LGBT duke treguar një interes të vërtetë praktik për nevojat e tyre

Veprimet/ objektivat e mëtejshme

Zgjerimi i praktikave të tilla të ofrimit të produkteve për të rinjtë, veçanërisht produkteve kontraceptive për ata që kanë më shumë gjasa të kryejnë marrëdhënie seksuale për herë të parë.



VIII. Praktikët që rekomandohen për të ardhmen

Siç theksohet në kapitullin 7 të këtij dokumenti, megjithëse një gamë e gjerë masash janë ndërmarrë nga OJQ-të, ato nuk kanë pasur ndikimin e dëshiruar tek të rinjtë e synuar. Në këtë kontekst, dhe duke marrë parasysh përvojat e tyre, të rinjtë kanë identifikuar një sërë praktikash që mund të jenë të dobishme për ta në situata krize siç është pandemia Covid-19.

Praktika që rekomandohen nga të rinjtë

Tek të gjitha kategoritë e të rinjve, kontaktet online, konsultimet dhe udhëzimet konsiderohen me rëndësi parësore. Të rinjtë në përgjithësi kanë një preferencë të fortë për një shumëllojshmëri të gjerë burimesh shtesë në internet, të tilla si farmacia online për të porositur produkte për vetpërdorim dhe një platformë në internet që ofron edukim seksual, duke përfshirë video të dobishme për edukimin seksual. Të rinjtë në situata të cenueshme janë gjithashtu veçanërisht të interesuar për këtë të fundit, duke vënë në pah rëndësinë e videove në edukim.

Mësimet e vazhdueshme lidhur me edukimin seksual në shkollë, të ofruara me mjete tradicionale, konsiderohen gjithashtu si prioritet i lartë.

Duke ditur rritjen e numrit të telefonatave gjatë pandemisë, linjat telefonike 24/7 mbi aspekte specifike të ShSR konsiderohen si shumë të rëndësishme nga të rinjtë në situata të cenueshme, veçanërisht ata nga komunitetet etnike të marginalizuara si romët dhe personat LGBT (në shumë raste si reflektim i shqetësimeve të tyre lidhur me privatësinë).

Për më tepër, një aplikacion celular/façe interneti me harta dhe orarin e hapjes së spitaleve më të afërta ose qendrave mbështetëse të OJQ-ve renditet gjithashtu lart për nga rëndësia në mesin e të rinjve të cenueshëm (si reflektim mbi rëndësinë e lartë që ata i kushtojnë aktiviteteve të OJQ-ve). Ky rekomandim jepet kryesisht nga personat nga zonat rurale dhe të rinjtë me status të ulët socio-ekonomik në zonat urbane. Gjithashtu, ofrimi i rregullt falas i prezervativëve, testeve dhe produkteve të higjienës menstruale në rajonin e tyre konsiderohet gjithashtu i një rëndësie mjaft të madhe, dhe kërkohet veçanërisht nga të rinjtë me status të ulët socio-ekonomik në zonat urbane.

Praktikat më të preferuara për të ardhmen

Të rinjtë në përgjithësi

Të rinjtë në situata të cenueshme

	%		%
Mjeku i përgjithshëm/mjeku i familjes/mjeku im ofron konsultime ose receta barnash përmes internetit	47	Mjeku i përgjithshëm/mjeku i familjes/mjeku im ofron konsultime ose receta barnash përmes internetit	42
Orë mësimore mbi edukimin seksual në shkollë	36	Një platformë në internet që ofron edukim seksual, duke përfshirë video të dobishme	31
Qendër komunitare në zonën ku jetoj	33	Orë mësimore mbi edukimin seksual në shkollë	30
Një farmaci online për të porositur pajisje/ teste/ilaçe për vetpërdorim pa recetë barnash	27	Linja telefonike 24/7 dedikuar aspekteve specifike të ShSR	29
Një platformë në internet që ofron edukim seksual, duke përfshirë video të dobishme	25	Qendër komunitare në zonën ku jetoj	28
Persona kontaktues në shkollën/universitetin tim	23	Një aplikacion celular/façe interneti me harta dhe orarin e punës së spitaleve më të afërta ose qendrave mbështetëse të OJQ-ve	24
Ekipet mobile të mjekëve, infermierëve ose terapistëve që vizitojnë rajonin ku jetoj	23	Një farmaci online për të porositur pajisje/ teste/ilaçe për vetpërdorim pa recetë barnash	24
Linja telefonike 24/7 dedikuar aspekteve specifike të ShSR	21	Ofrimi i rregullt falas i prezervativëve, testeve, produkteve të higjienës menstruale etj. në rajonin ku jetoj	22
Sesione ose seminare të rregullta në internet (p.sh. Zoom, Teams etj.)	21	Sesione ose seminare të rregullta në internet (p.sh. Zoom, Teams etj.)	19

G. Aspektet kryesore që duhet marrë parasysh

Bazuar në gjetjet e studimit mes të rinjve në Kosovë të përshkruara në këtë raport, një sërë aspektesh duhet të merren parasysh në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve që adresojnë nevojat e të rinjve në lidhje me ShDSR, si në përgjithësi ashtu edhe në kohë të krizave siç është pandemia Covid-19. Në veçanti, mund të merren parasysh dhe adresohen aspektet në vijim.

Kërkimi dhe qasja në informacione mbi çështjet e ShDSR

Mungesa e njohurive mbi çështjet e ShDSR-së daton qysh para pandemisë Covid-19, veçanërisht në mesin e adoleshentëve dhe të rinjve në situata të cenueshme. Deri në njëfarë shkalle, kjo mungesë njohurie (dhe rrjedhimisht edhe kërkimi i informacionit) rezulton nga perceptimi se të rinjtë mund t'i trajtojnë vetë çështjet dhe pyetjet e tyre lidhur me ShDSR (veçanërisht të rinjtë nga komunitetet etnike të marginalizuara dhe ata në zona rurale), gjersa tema e ShDSR mbetet tabu si në shoqëri ashtu edhe në sferën e arsimit.

Përafërsisht dy në pesë të rinj në përgjithësi raportuan se ishin të preokupuar me çështje të tjera më shumë sesa me kërkimin e informacionit ose shërbimeve të ShDSR gjatë pandemisë Covid-19. Megjithatë, pavarësisht mungesës së prioritizimit të çështjeve të ShSR, pandemia duket se ka nxitur një nevojë më të madhe për informacione mbi një sërë temash si shtatzënia, praktikimi i seksit të sigurt, IST-të dhe marrëdhëniet seksuale dhe intime, lidhur me të cilat nuk janë dhënë informata sa duhet. Në veçanti, duhet të merren parasysh masat e mëposhtme:

- Shpërndani më shumë informacione mbi aspektet që lidhen me shëndetin mendor dhe mirëqenien psikologjike. Kjo u raportua nga të rinjtë si tema ku urgjenca për marrjen e informatave ishte më e madhja gjatë pandemisë Covid-19.
- Komunikimi i shënjestruar me të rinjtë në situata të cenueshme siç janë ata nga komunitetet etnike të

margjinalizuara dhe ata në zonat rurale në veçanti. Temat kryesore për t'u marrë parasysh që nuk u trajtuan në mënyrë adekuate gjatë pandemisë Covid-19 përfshijnë ndërprerjen e shtatzënisë/ abortit dhe shtatzënia në përgjithësi, praktikimi i seksit të sigurt, IST-të, marrëdhëniet seksuale dhe intime dhe aspekte të përgjithshme të planifikimit familjar.

- Informoni të gjithë të rinjtë pa dallim për çështje që lidhen me dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore. Kjo duhet të përfshijë informata të përgjithshme se si të raportohen incidentet dhe si dhe ku të kërkohet mbrojtje, por edhe si të raportohen dhe trajtohen rastet e dhunës në internet, si bullizmi kibernetik kur paraqitet nevoja për diskutim lidhur me çështjet e ShSR në rrjetet sociale, që është përhapur më shumë gjatë pandemisë Covid-19.
- Shtoni shkëmbimin e informacionit përmes internetit lidhur me të drejtat e të rinjve nga komuniteti LGBT për të shprehur lirisht identitetin e tyre gjinor dhe orientimin seksual.
- Siguroni informacione të përshtatura, dhe të përshtatshme për moshën e të rinjve në lidhje me ndikimin e Covid-19 në aspekte të caktuara të ShSR.
- Shtoni numrin e informatave në lidhje me ShDSR në të gjitha gjuhët. Në veçanti, të rinjtë që i përkasin komunitetit serb raportuan një barrierë në qasje, sepse informacioni është kryesisht i hartuar vetëm në gjuhën shqipe.
- Trajtoni mungesën e njohurive lidhur me çështjet e ShDSR qysh nga themeli, duke u fokusuar në tema specifike në edukimin seksual. Kjo duhet të kryhet njëkohësisht në arsimin formal jashtëshkollor (që aktualisht perceptohet nga adoleshentët si më efektiv) dhe brenda kurrikulës shkollore. Temat që u theksuan si me interes të veçantë nga adoleshentët përfshijnë sëmundjet që lidhen me ShSR, mbrojtjen dhe komplikimet gjatë marrëdhënieve seksuale dhe pasojat e mundshme, njohja e simptomave të IST-

ve, çështjet e pëlqimit dhe rritja e ndërgjegjësimit që një person nuk duhet të fillojë një lidhje ose të martohet me dikë vetëm për shkak se ka kryer marrëdhënie seksuale.

Në adresimin e nevojave të sipërpërmendura, mund të merret parasysh përdorimi i kanaleve të mëposhtme:

- Rritja e përfshirjes së organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve në Kosovë, aktivitetet e të cilave u pritën shumë pozitivisht nga të rinjtë gjatë pandemisë Covid-19. Në këtë kontekst, do të ishte e dobishme përfshirja e OJQ-ve vendore në një shkallë më të madhe, në mënyrë që ato të përfshihen më shumë në shpërndarjen e informacionit, si në kohë krize ashtu edhe më gjerë në të ardhmen. Ky rol gjithashtu mund të integrohet në edukimin formal seksual duke u ofruar OJQ-ve qasje dhe lidhje me mjedisin shkollor.
- Kombinoni kanalet online dhe kanalet tradicionale të mediave: nga njëra anë, gjatë pandemisë Covid-19 ka pasur një kalim të dukshëm kolektiv në përdorimin e kanaleve në internet (rrjeteve sociale, faqe interneti, blogje ose aplikacione), duke u bërë kështu kanale informimi. Në të njëjtën kohë, të rinjtë në situata të cenueshme për shkak të mungesës së qasjes në internet raportuan se kishin mbetur të painformuar, duke sugjeruar që edhe TV dhe radio duhet të përdoren për të shpërndarë informacione.
- Hulumtoni mënyrat se si farmacitë mund të luajnë një rol më aktiv në shkëmbimin e informacionit me të rinjtë në situata të cenueshme. Farmacitë ishin një burim të cilit të rinjtë iu qasën më shumë gjatë pandemisë Covid-19.

Qasja në shërbimet dhe produktet e ShSR

Pandemia Covid-19 ka krijuar pengesa të mëtejshme në kërkimin e shërbimeve të ShSR për të rinjtë, duke rezultuar që të rinjtë të demotivohen për t'i kërkuar ato në radhë të parë. Konkretisht duhet trajtuar aspekte në vijim:

- Trajtimi i disponueshmërisë së përgjithshme të shërbimeve për të rinjtë në situata të cenueshme. Mbyllja e qendrave lokale të komunitetit dhe orët e kufizuara të hapjes së qendrave shëndetësore, së bashku me kufizimet e lëvizjes, i kanë penguar të rinjtë të kenë qasje në shërbimet ShSR.
- Përmirësimi i qëndrimeve të mjekëve në ofrimin e shërbimeve të tyre për të rinjtë. Në një kontekst ku të rinjtë janë ndier gjithmonë jorehat për të kërkuar shërbime ShSR, qasja e përgjithshme e mjekëve ndaj

të rinjve në mënyrë specifike ka qenë jo miqësore, pa vëmendjen e duhur dhe me diskriminim edhe më të madh gjatë Covid-19 ndaj të rinjve të grupeve të marginalizuara etnike dhe të rinjve të komunitetit LGBT në veçanti. Shqetësimet e të rinjve lidhur me privatësinë dhe konfidencialitetin e tyre duhet të merren parasysh në këtë kontekst.

Për më tepër, duhet të adresohen problemet në qasje me të cilat përballen të rinjtë gjatë pandemisë Covid-19, duke përfshirë aspektet në vijim:

- Personeli adekuat shëndetësor në qendra shëndetësore dhe spitale. Probleme të veçanta u raportuan nga të rinjtë për sa i përket vonesave të hasura ose pamundësisë së plotë për t'u shërbyer për shkak të se profesionistëve mjekësorë dhe psikologëve u ishin deleguar përgjegjësi të tjera të menaxhimit me situatën me Covid-19.
- Ofrimi i shërbimeve të këshillimit për vajzat në veçanti. Vajzat që u bënë seksualisht aktive për herë të parë gjatë pandemisë Covid-19 raportuan se qasja në shërbime të tilla ishte problematike.
- Shpërndarja e pandërprerë e produkteve për të rinjtë dhe komunitetet në situata të cenueshme, veçanërisht produktet kontraceptive dhe prezervativëve. Në këtë kontekst, do të ishte e rëndësishme të sigurohet funksionimi i farmacive me orar të zgjatur pune në të gjitha komunitetet, një shërbim që u mungonte të rinjve në zonat rurale gjatë pandemisë Covid-19 më shpesh se para pandemisë.
- Organizimi i shërbimeve të konsultimit me mjekët në mënyrë efektive përmes telefonit, duke pasur parasysh vështirësitë që hasen në kryerjen e konsultave sy më sy. Të rinjtë kanë përdorur telefonatat në një shkallë shumë më të madhe se përpara pandemisë, duke krijuar kështu një zgjidhje afatshkurtër për problemin e tyre. Roli i mjekut të familjes/mjekut të përgjithshëm duhet të jetë kryesor në këtë përpjekje, duke qenë se të rinjtë besojnë se pandemia Covid-19 ka treguar se është shumë e rëndësishme të kesh një mjek të cilit mund t'i besohet. Kjo vlen si për popullatën e përgjithshme rinore, por edhe për të rinjtë në situata të cenueshme, të cilët mund të ketë nevojë në disa raste që t'u caktohet një mjek personal.

Të rinjtë raportuan një tendencë të madhe nga ana e mjekëve të sektorit publik për t'i referuar për mbështetje nga mjekët privatë gjatë pandemisë Covid-19. Në këtë kontekst, megjithëse është padyshim e rëndësishme të adresohen mangësitë e mëdha të kapaciteteve të sistemit shëndetësor

publik, mund të merret në konsideratë përfshirja e mjekëve të sektorit privat në përpjekjen e përgjithshme për të ofruar shërbime ShSR për të rinjtë gjatë kohës së krizave. Duke pasur parasysh kufizimet për qasje në shërbimet shëndetësore të sektorit publik, është gjithashtu e rëndësishme të sigurohen investime sistematike në sistemin e kujdesit shëndetësor publik për të siguruar që qasja në shërbime cilësore të mundësohet për ata që janë në kushte të rënda financiare, veçanërisht për të rinjtë nga zonat rurale, disa nëna të reja pa mbështetje financiare dhe vajzat dhe gratë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Aspektet që duhet marrë parasysh për gratë e reja shtatzëna dhe nënat e reja.

Në përpjekje për t'i adresuar nevojat e tyre të shtuara për informata në lidhje me ShSR, nënat e reja dhe gratë shtatzëna kanë përdorur në masë të madhe mjetet online së bashku me bisedat telefonike dhe shkëmbimet me email me mjekët e tyre për të marrë informatat e nevojshme për çështjet e përgjithshme të planifikimit familjar, vendimmarrjen për të pasur fëmijë dhe të kuptuarit se si virusi Covid-19 dhe vaksinimi kundër tij ndikojnë në shtatzëninë dhe shëndetin e tyre, si dhe atë të fetusit ose foshnjës së porsalindur. Në këtë kontekst, duhet bërë përpjekje për t'i informuar nënat e reja për burimet online ose faqet e internetit që ofrojnë informacion të besueshëm dhe të saktë, si dhe të rritet numri i informatave të cilave ato ju qasen.

Për sa i përket disponueshmërisë së informatave dhe qasjes në shërbime, duhet të merren parasysh një sërë masash për përmirësime të mëtejshme, veçanërisht në kohë krize, duke pasur parasysh problemet me të cilat janë përballur në këtë drejtim:

- Sigurohuni që të mos mungojnë në kontrollat e rregullta gjinekologjike dhe të monitorimit të shtatzënisë. Duhet të hartohen procedurat në qendrat shëndetësore dhe masat paraprake të sigurisë ndaj Covid-19 duhet t'u komunikohen grave shtatzëna për t'i inkurajuar ato që ta kryejnë me sukses planifikimin e vizitave të tyre dhe ta kapërcejnë frikën.
- Ofroni staf adekuat mjekësor, pos mjekëve. Pandemia e Covid-19 ka çuar në rritje të presionit ndaj stafit, duke kontribuar në mungesën e respektit që ata e shfaqin ndaj grave shtatzëna.
- Sigurohuni që ofruesit e kujdesit shëndetësor të ofrojnë përkujdesin mjekësor të nevojshëm—si për shembull, nëpërmjet trajnimit dhe mbështetjes. Gratë shtatzëna kanë raportuar për raste të mungesës së profesionalizmit dhe neglizhencës.

- Siguroni ofrimin e vazhdueshëm të trajtimit të fertilitetit dhe testimit të shtatzënisë nga mjekët. Këto shërbime ose nuk ofroheshin ose nuk mund të qaseshin për shkak të kufizimeve të lëvizjes në vend gjatë pandemisë.

- Siguroni një rrugë të qartë dhe të shpejtë për caktimin e vizitave urgjente. Grave shtatzëna dhe nënave të reja nuk u ishte ofruar një nivel i tillë shërbimi.

- Ofroni këshillim të specializuar psikologjik për gratë shtatzëna, duke pasur parasysh shtimin e nevojave të tyre emocionale që rrjedhin nga situata e tyre dhe presioni i pandemisë Covid-19.

Shëndeti mendor dhe mbështetja psikologjike

Në fushën e shëndetit psikologjik dhe mendor janë paraqitur nevoja të veçanta për sa i përket kërkimit të informacionit, e që kanë qenë të ndërlidhura ngushtë me një ndikim të fortë negativ të pandemisë Covid-19 në shëndetin psikologjik personal të të rinjve, dhe veçanërisht të atyre nga komunitetet etnike, të rinjtë e komunitetit LGBT dhe nënat e reja. Në këtë kontekst, ka pasur një rritje të dukshme të përqindjes së të rinjve që kanë kërkuar mbështetje. Sidoqoftë, kërkesat e tyre kryesisht janë drejtuar kah familja dhe miqtë dhe burimet e përgjithshme në internet, në vend që të kërkonin mbështetje profesionale. Për të rritur qasjen në shërbimet e mbështetjes profesionale në mënyrë efektive, duhet të merren parasysh masat e mëposhtme:

- Të zbatohet një plan emergjent i gatishmërisë posaçërisht për shërbimet e shëndetit mendor dhe të sigurohet disponueshmëria e burimeve në mënyrë që të plotësohet kërkesa në rritje në kohë krizash.
- Të ofrohen informata se ku ose si mund të merret mbështetje psikologjike. Mjetet online dhe digjitale vlen të merren parasysh në këtë drejtim, duke ditur nivelin e lartë të përdorimit të këtyre kanaleve të rinjtë me qasje në internet.
- Rritja e kapacitetit të linjave telefonike në kohë krize dhe kur ka rritje të kërkesave. Linjat telefonike ishin njëri ndër kanalet të cilit të rinjtë në situata të cenueshme iu drejtuan më shumë gjatë pandemisë Covid-19.
- Të pranohet fakti se çështjet e shëndetit mendor me të cilat përballen të rinjtë në situata të cenueshme është rezultat i rritjes së presionit financiar gjatë kohëve të krizës dhe prandaj duhet të gjendet një zgjidhje që shërbimet profesionale të

shëndetit mendor të jenë më të përballueshme për nga aspekti financiar për ta.

- Ofrimi i shërbimeve të specializuara të mbështetjes psikologjike për të mbijetuarat e dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore, duke qenë se ekspozimi ndaj dhunës kontribon në rritje të stresit dhe të problemeve të shëndetit mendor, veçanërisht për gratë e reja që jetojnë në familje patriarkale, siç janë gratë rome.
- Trajtoni problemet psikologjike në thelb, duke marrë parasysh presionin e shtuar financiar dhe ekspozimin ndaj dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore, me të cilën janë përballur sidomos të rinjtë në situata të cenueshme.
- Mbani aktivitete ndërgjegjësuese për të zvogëluar konfuzionin në lidhje me dallimin midis një psikologu dhe një psikiatri, si përpjekje për të destigmatizuar shërbimet e mbështetjes psikologjike. Reagimet nga të rinjtë treguan se ofrimi i mbështetjes nga një psikolog dhe jo nga një psikiatër do të ishte një hap i vogël fillestar drejt zvogëlimit të stigmës.

Dhuna seksuale dhe dhuna me bazë gjinore

Më shumë se një në pesë të rinj në Kosovë kanë pohuar se ose kanë përjetuar ose kanë qenë dëshmitarë të një incidenti të dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore gjatë pandemisë Covid-19. Kjo incidencë është veçanërisht e lartë tek të rinjtë nga komunitetet e marginalizuara etnike si romë, ashkali apo egjiptianë. Të rinjtë besojnë fuqishëm se shteti nuk i ka trajtuar në mënyrë adekuate problemet e tilla (59% e popullsisë së përgjithshme rinore dhe 48% e të rinjve në situata të cenueshme e shprehën këtë mendim).

Megjithë incidencën në rritje të dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore gjatë pandemisë Covid-19, më shumë se dy në pesë nga ata që kanë hasur incidente të tilla ose nuk dinin të kërkonin mbështetje ose nuk ndërmorën asnjë veprim,

duke sugjeruar kështu se ekziston një nevojë e konsiderueshme për aktivitete komunikimi për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e kërkimit të mbështetjes dhe pikave specifike të kontaktit tek të cilat viktimat ose dëshmitarët mund të drejtohen. Për më tepër, të rinjtë pohojnë se mbështetja që u nevojitet shpesh nuk është ofruar. Në këtë kontekst, duhet të merren parasysh masat e mëposhtme:

- Promovimi i aplikacioneve celulare për kërkimin e vendndodhjes së pikave të kontaktit që janë pranuar pozitivisht nga ata që janë në dijeni të tyre.
- Rritja e numrit të psikologëve për çështje që lidhen me dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore, meqenëse të rinjtë kanë raportuar se kanë shumë nevojë për ta.
- Rritja e kapaciteteve të OJQ-ve për të ofruar mbrojtje ose udhëzime. Aktualisht ekzistojnë të paktën pesë OJQ që punojnë në mënyrë specifike në çështjet e dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore dhe ofrojnë mbështetje psikologjike. Të rinjtë u janë drejtuar atyre shumë më tepër sesa institucioneve mbrojtëse si policia apo strehimoret, por megjithatë mbështetja e marrë shpesh ka munguar në aspektin e aftësisë për t'u ofruar ose për t'i udhëhequr drejt strehimit apo mbrojtjes efektive fizike. Është e nevojshme të përmirësohet qëndrueshmëria dhe kapacitetet e OJQ-ve, veçanërisht në kohë krizash.
- Rishikimi i udhëzimeve lidhur me mënyrën se si autoritetet zyrtare mbrojtëse si policia i trajtojnë incidentet e dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore, dhe ofrimi i mbështetjes në formë trajnimi. Kjo do t'i mundësonte autoriteteve të luanin një rol të rëndësishëm për të rinjtë dhe do të konsiderohej si përpjekje më gjerë e koordinuar për trajtimin e sfidave që paraqet dhuna seksuale dhe dhuna me bazë gjinore, dhe në të njëjtën kohë do të qartësonte standardet dhe procedurat që priten të ndiqen nga këto autoritete gjatë reagimit ndaj incidenteve të dhunës seksuale dhe me bazë gjinore.

IPPF Rrjeti Evropian është një nga gjashtë rrjetet rajonale të Federatës Ndërkombëtare të Prindërimit të Planifikuar. IPPF EN punon në mbi 40 shtete në të gjithë Evropën dhe Azinë Qendrore për të fuqizuar të gjithë, sidomos për më të përjashtuarit nga shoqëria, për të bërë një jetë seksuale dhe riprodhuese të sigurt dhe dinjitoze, pa dëmtim dhe diskriminim.

Email info@ippfen.org -  [@ippfeurope](https://www.facebook.com/ippfeurope)  [@ippfen](https://twitter.com/ippfen)  [You Tube](https://www.youtube.com/ippfen) IPPF European Network

www.ippfen.org